



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 6 (827758)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 Shkurt 2022

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës



Përfundon mandatin atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në Shqipëri

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Bashkim Shillova, në kuadër të përfundimit të mandatit të tij në Tiranë. Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak të shkëlqyer midis dy

vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke nënvizuar rolin aktiv të kolonel Shillovës në forcimin e marrëdhënieve midis dy forcave të armatosura në fushën e trajnimit, stërvitjes dhe aktiviteteve të përbashkëta. Nga ana e tij, kolonel Shillova e falenderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA për... >>> faqe 2

Interviste me ish-portierin e Kombëtares shqiptare dhe të skuadrës së Partizanit

Legjenda e portës shqiptare Perlat Musta



>>> faqe 6-7

Ministeriali i Mbrojtjes së NATO-s

Peleshi: Shqipëria e gatshme të shtojë kontributin në kufijtë juglindorë të Aleancës

Ministri i Mbrojtjes: Jemi në rrugën e duhur për të rritur në 2% të PBB shpenzimet për Mbrojtjen

>>> faqe 3



Forca Detare

Kundëradmiral Agastra: Mbështetja me kurse dhe trajnime të vazhdueshme për efektivët tanë në Turqi, një element shumë i rëndësishëm për FD

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adanand Agastra dhe shefi i shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj pritën në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonelin Muhammet Kelami Kablay. Pas urimit të mirëseardhjes, kundëradmiral Agastra vlerësoi nivelin e bashkëpunimit të gjatë me Forcat e Armatosura...



>>> faqe 4

"Biza-22"

Gjeneral brigade Kingji: Konferenca, momenti i duhur për të ofruar të gjitha kapacitetet intelektuale dhe profesionale

Në ambientet e Forcës Tokësore, u zhvillua konferenca e parë planëzuese e stërvitjes "Biza-22". Fillimi i këtij aktiviteti, u ndoq nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Pjesëmarrës të tjerë në konferencë ishin edhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm... >>> faqe 5



Takimet e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s

>>> faqe 9

FORCA TOKËSORE

Gjeneral brigade Kingji: Konferenca, momenti i duhur për të ofruar të gjitha kapacitetet intelektuale dhe profesionale

>>> faqe 5

SPECIALE

Konflikti në Ukrainë, drejt "racionalitetit" apo "çmendurisë"?

>>> faqe 10-11

TAKIMI

Përfundon mandatin atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në Shqipëri

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH i akordon certifikatë mirënjohje

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Bashkim Shillova, në kuadër të përfundimit të mandatit të tij në Tiranë.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak të shkëlqyer midis dy vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke nënvizuar rolin aktiv të kolonel Shillovës në forcimin e marrëdhënieve midis dy forcave të armatosura në fushën e trajnimit, stërvitjes dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Nga ana e tij, kolonel Shillova e falenderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA për mbështetjen e treguar nga FARSH gjatë kohës së qëndrimit të tij në detyrë.



Në përfundim të takimit, gjeneralmajor Begaj, duke e uruar suksese të mëtejshme, i akordoi kolonel Shillovës një "Certifikatë Mirënjohje" në shenjë falenderimi për kontributin e dhënë gjatë kryerjes së detyrës në Shqipëri.



Rreth 300 pako ushqimore dërgohen për fshatrat e thellë të Burrelit dhe Peshkopisë

Rreth 300 pako kryesisht me ushqime dhe detergjentë u shpërndanë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, nëpërmjet mjeteve të transportit të Forcave të Armatosura në bashkitë Mat dhe Dibër. Pakot ushqimore u siguruan nga Rezervat Materiale të Shtetit pas kërkesës së bërë nga kryetarët e këtyre bashkive.

Pakot në këto zona të thella u dërguan në ndihmë të familjeve në nevojë, ato me probleme sociale, shëndetësore apo të moshuar që jetojnë vetëm dhe që kanë hasur vështirësi të theksuara nga moti i ashpër dhe



temperaturat e ulëta.

Në bashkinë Mat u transportuan 150 pako ushqimore dhe detergjentë, të cilat sipas planit të hartuar nga vetë administratorët lokalë u shpërndanë në fshatrat më të thellë të njësive administrative Derjan, Macukull, Lis, Koms, Baz dhe Ulëz.

Nga ana tjetër mjetet e batalionit të transportit dhe efektivë të batalionit të mbështetjes rajonale transportuan 145 pako në bashkinë Dibër, të cilat u shpërndanë banorëve më në nevojë të fshatrave të njësive administrative Lurë, Selishtë, Zall-Dardhë, Reç dhe Kala e Dodës.

Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile janë në komunikim të vazhdueshëm me bashkitë dhe prefekturat, në territorin e të cilave shkaktohen probleme nga bora dhe temperaturat e ulëta dhe janë të gatshme në çdo moment të ofrojnë ndihmën e tyre.

Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse

Përfundon me sukses kursi i dytë i menaxhimit fizik të municioneve në Qendrën Stërvitore

Përfundoi me sukses kursi i dytë i menaxhimit të sigurisë fizike të municioneve, zhvilluar në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse me drejtues kolonel Ylli Zyla. Gjatë këtij kursi dyjavor kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar 15 ushtarake nga të cilët katër shqiptarë të Kosovës, me instrukturë britanikë.

Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli, Atasheu Ushtarak Britanik, nënkolonel Christopher Maycock, këshilltari britanik i FSK-së në Kosovë, nënkolonel John Hunter dhe atasheu ushtarak i Kosovës, kolonel Bashkim Shillova.

Në fjalën e tij të rastit, kolonel Arben Dhuli, shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse shprehu falënderimet për mbështetjen e palës britanike dhe instrukturët përkatës për kontributin e tyre në përgatitjen e personelit pjesëmarrës, si dhe kursantët për angazhimin dhe përgatitjen në pikëpamje të menaxhimit të municioneve. Në mënyrë të veçantë, ai falënderoi kursantët shqiptarë të Kosovës, të cilët janë përkushtuar dhe kanë dhënë maksimumin e tyre gjatë kursit, duke spikatur me impenjimin e korrektesën e shfaqur duke shprehur bindjen e vijimit të këtij bashkëpunimi të ngushtë e vëllazëror me Komandën Mbështetëse.

"Ne sot jemi dëshmitarë të domosdoshmërisë dhe të vijimit me sukses të këtij kursi i cili përveç trajnimit të personelit për administrimin e sigurinë



e municioneve sjell edhe benefitin e njohjes me praktikën ndërkombëtare në këtë fushë", -u shpreh kolonel Dhuli.

Nga ana e tyre, atasheu ushtarak britanik Maycock dhe këshilltari britanik i FSK-së në Kosovë, nënkolonel John Hunter theksuan mbështetjen e për vazhdimësinë e këtyre kurseve në nivele edhe më të larta në të ardhmen; gjë e cila u përshëndet e u vlerësua edhe nga atasheu ushtarak i Kosovës kolonel Shillova.

Ky kurs është i dyti i këtij lloji, i cili nisi me ndihmën e mbështetjen amerikane në vitin 2021, në një specialitet tepër të rëndësishëm e detyrë specifike

e të ndjeshme, siç është menaxhimi i municioneve në Forcat e Armatosura. Në këtë pikëpamje nga pjesëmarrësit u vlerësua në mënyrë të veçantë edhe kontributi i stafit të Qendrës Stërvitore me në krye komandantin e tyre, kolonel Ylli Zyla, për masat e marra dhe kushtet e krijuara për mbarëvajtjen e këtij kursi, për vizionin largpamës e ambicijet pozitive në pikëpamje të rritjes cilësore dhe metodave të kombinuara me praktikën të cilat i shërbejnë përmirësimit të kurrikulave të Qendrës Stërvitore. Në përfundim të ceremonisë, pjesëmarrësve u dorëzuan certifikatat përkatëse.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

16-17 shkurt 2022/ Takimi dyditor i ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës

Ministri Peleshi: Shqipëria e gatshme të shtojë kontributin në kufijtë juglindorë të Aleancës

Ministeriali i Mbrojtjes së NATO-s, Peleshi: Jemi në rrugën e duhur për të rritur në 2% të PBB shpenzimet për Mbrojtjen

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi mori pjesë në takimin dyditor të ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës, i cili u zhvillua në selinë e NATO-s në Bruksel.

Ndonëse kriza aktuale e shkaktuar nga dislokimi i forcave të mëdha ushtarake ruse në kufijtë e Ukrainës ka tërhequr vëmendjen e audiencës në mbarë botën dhe përbën një moment mjaft kulmor që pas Luftës së Ftohtë, në axhendën e këtij takimi do të diskutohen edhe çështje të tjera mjaft të rëndësishme si: Koncepti i ri Strategjik; Forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes së Aleancës; Shpenzimet e Mbrojtjes; Ndarja e drejtë e barrës ndërmjet Aleatëve; Partneriteti NATO - BE; etj.

Ministri i Mbrojtjes z. Peleshi, në fjalën e tij theksoi qëndrimin e unifikuar të Shqipërisë me vendet e tjera Aleate se çdo vend është i lirë dhe ka të drejtën sovranë për të zgjedhur rrugën e vet në aleancat e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe orientimin e politikës së jashtme. Gjithashtu, ai përmendi rolin e Shqipërisë si bashkëpunëmbajtëse me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi çështjen e Ukrainës.

Më tej, ministri Peleshi theksoi rëndësinë e ruajtjes së solidaritetit dhe kohezionit që Aleanca duhet të tregojë gjithmonë, por veçanërisht në këtë moment. Ai nuk la pa përmendur dhe vlerësuar rolin e pazëvendësueshëm të Komandave Strategjike dhe strukturave të tjera të NATO-s, në mobilizimin dhe gatishmërinë e përhershme në ruajtje të kufijve të vendeve të Aleancës.

Për këtë, ministri Peleshi solli në vëmendje kontributet aktuale të vendit tonë në kuadër të Aleancës, si dhe vendimet më të fundit për mundësinë e shtimit të kontributit në kufijtë juglindorë të Aleancës, sipas modelit të Prezencës së Përfortuar të Përpëruar në vendet Baltike (eFP). Për sa i përket zhvillimit dhe implementimit të kapaciteteve të Mbrojtjes, z. Peleshi rikonfirmoi edhe njëherë angazhimin e Shqipërisë për përmbytjen e Zotimit për Investime në Mbrojtje që vendet anëtare morën në Samitin e Uellsit në 2014, për arritjen e buxhetit të Mbrojtjes deri në vitin 2024 në jo më pak se 2% të PBB.

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i kushtoi vëmendje të veçantë edhe hartimit të Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, duke vlerësuar kohën që ai vjen, si mjaft të duhur dhe të rëndësishme, për faktin që situata e sigurisë dhe rreziqet në mbarë globin po zhvillohen në mënyrë mjaft të paparashikueshme dhe kaotike.

Në këtë kuadër, zoti Peleshi kërkoi që rajonit të Ballkanit t'i kushtohet vëmendja e duhur në hartimin e Konceptit të ri Strategjik të NATO-s



Ministri i Mbrojtjes z. Peleshi, në fjalën e tij theksoi qëndrimin e unifikuar të Shqipërisë me vendet e tjera Aleate se çdo vend është i lirë dhe ka të drejtën sovranë për të zgjedhur rrugën e vet në aleancat e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe orientimin e politikës së jashtme. Gjithashtu, ai përmendi rolin e Shqipërisë si bashkëpunëmbajtëse me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi çështjen e Ukrainës.

Presidenti Meta pret në takim ministrin e Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj

Presidenti Republikës, SH.T. z. Ilir Meta u takua me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Gjatë takimit u nda shqetësimi i përbashkët me të gjithë partnerët tanë të NATO-s për kërcënimin e një agresioni të mundshëm rus ndaj Ukrainës, që do të ishte një shkelje flagrante e të drejtës ndërkombëtare.

Presidenti Meta nënvizoi rëndësinë e koordinimit sa më të efektshëm me Aleancën, si dhe marrjen e masave për vijimin e reformave në funksion të forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve tona mbrojtëse. Në këtë kontekst, u vlerësua edhe plotësimi dhe fuqizimi i gjithë zinxhirit komandues në Forcat e Armatosura, në përputhje me sistemin gradë-funksion.



Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral priti në një takim atasheun e Republikës së Turqisë, kolonelin Kablay

Kundëradmiral Agastra: Mbështetja me kurse dhe trajnime të vazhdueshme për efektivet tanë në Turqi ,një element shumë i rëndësishëm për FD

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adanand Agastra dhe shefi i shtabit të Forcës Detare kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj pritën në një takim atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonelin Muhammet Kelami Kablay.

Pas urimit të mirëseardhjes, kundëradmiral Agastra vlerësoi nivelin e bashkëpunimit të gjatë me Forcat e Armatosura turke në përgjithësi por në veçanti me Forcën Detare. Ai shtoi se mbështetja me kurse dhe trajnime të vazhdueshme për efektivet tanë në Turqi, ka qenë një element shumë i rëndësishëm për sa i përket arsimimit të personelit të Forcës Detare.



Nga ana e tij koloneli Kablay, falënderoi komandantin e Forcës Detare për mikpritjen dhe shprehu gatishmërinë e tij personale dhe të Forcave të Armatosura të Turqisë për të vazhduar dhe shtuar bashkëpunimin në çdo fushë që të dy palët e shohin me interes të përbashkët.

Zëvendës ambasadorja dhe atasheu ushtarak grek zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare

Kundëradmiral Agastra: Falënderues për ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm të FA greke për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e standardeve të NATO-s

Komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, paraditen e sotme priti në një vizitë kortezie zëvendës ambasadorin e Republikës së Greqisë në vendin tonë, znj. Stavroula Pentarvani si edhe atasheun ushtarak, kolonelin Efthymios Ntallas.

Mbasi u uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare, kundëradmiral Agastra i falënderoi për ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm të Forcave të Armatosura greke për Forcat tona të Armatosura, njëkohësisht i njohu ata me punën dhe përpjekjet që ka bërë efektivi i Forcës Detare për realizimin e misionit në det dhe përmbushjen e angazhimeve e standardeve të NATO-s

Nga ana e saj, zëvendës ambasadorja znj. Pentarvani falënderoi komandantin e Forcës Detare për ftesën dhe mikpritjen në mjediset e Forcës Detare si dhe shprehu mundësinë për rritjen e bashkëpunimit të zbatimit të ligjshmërisë në det midis dy vendeve. Atasheu ushtarak grek koloneli Ntallas në fjalën e tij diskutoi mbi planet e bashkëpunimit dypalësh për vitin 2022.



"IN MEMORIUM" Për Komandantin himarjot Aleko Dede...

U bë një vit që është ndarë nga jeta Komandanti, miku dhe prindi Aleko Dede. Aleko u lind në vitin 1937. Në vendlindje, ai kreu arsimin fillor e 7-vjeçar. Më pas shkollën "Skënderbej" dhe Akademinë e Marinës Vlorë.

Mbasi kreu me sukses Akademinë e Marinës, Aleko, navigator i ri, u caktua në Flotën Luftarake-Detare në Pashaliman, në Brigadën e Nëndetëseve me detyrën e Komandantit të Anijes Silur-kapëse. Që kur erdhi në Flotën Luftarake-Detare Aleko solli pak Himarë, solli fisnikërinë e kësaj zone historike, solli legendat e saj të panumërta për detin, solli burrërinë e qëndrësën para çdo vështirësie, para çdo dallge në det e në tokë! Aleko ka qenë e mbeti si njëri nga bijtë më fisnik e më kreshnik të bregdetit e Himarës, i ditur, i paepur, njerëzor, trim, i përkushtuar në çdo detyrë, i dashur e respektuar me shokët, koleget e vartësit, i shkrirë me të gjithë detarët e kuadrot, me një komunikim shumë shoqëror e miqësor, me një buzëqeshje të lindur si një valë deti që të bënte për vete, si një babaxhan, si në urën e komandimit dhe pranë oxhakut, ku me bisedat e paharruara të tij, shkëlqente e ngrohte si ai zjarri bubulak dhe fitonte vëmendjen e respektin e të gjithëve. Ai me urtësinë e burrërinë e tij, të bënte që ta kishe për model e t'i ngjaje atij burri! Për punë të mirë, disiplinë, ndershmëri e profesionalizëm në zbatimin e detyrave, Leko, tashmë oficer i pjekur u transferua në anijet ndihmuese të Flotiljes së Durrësit, Kepi i Palit, ku shërbeu disa vite. Në librin "Antologjia e Detarisë Shqiptare", vëllimi i dytë, faqe 622 thuhet: "Më 23 qershor 1972, KS-270, me Komandant Aleko Dede, zhvilloi qitjen e I-rë me silurë kundër anijes "Patosi" në gjirin e Lalzit. Po ky Kater, i drejtuar nga Komandant Aleko, në korrik 1972, ndihmoi anijen panameze "Norma", 60 mijle në VP të kepit të Rodonit... Si kuadër e detar i aftë, Leko ka lënë gjurmë gjithandej, në hapësirën detare shqiptare. Por, kuadri i përgatitur, kërkohet kudo dhe ngarkohet me detyra të vështira. Kështu Lekoni nga BUD-i Durrës, e caktojë Komandant Skuadrilje në Bazën Ushtarake Detare të Shëngjinit, të sapo krijuar, në vijim, disa vite Komandant i Regjimentit të Katerave Silurues në Shëngjin, deri në vitin 1981. Aleko ishte një



detar i lindur, sikur ishte përkundur në djepin e dallgëve, s'pyeste në se ka det me dallgë apo ishte bunacë. Ai kënaqej e gëzonte kur dilte në det, i dukej si shtëpia e tij, sikur vallëzonte me dallgët. Dhe ishte shembull e frymëzimit qëndresë dhe për ndonjë detar e kuadër, që e lodhte sëmundja e detit. Aleko mes kuadrove e detarëve ngjante si ai rrapi i moçëm që nuk vend të hijes, shpërdante eksperiencën e detarit të vjetër, qëndresën, fisnikërinë e burrërinë e tij, të krahinës nga vinte!

Nga këtu u transferua në Bazën Detare Durrës, me detyrë Komandant i Detachmentit të Minimit, detyrë të cilën e kreu deri sa doli në pension... Komandanti nga Himara, ALEKO DEDE, çdo detyrë e kreu me nder dhe përkushtim atdhetar. Aleko ka një meritë të veçantë në përgatitjen e aftësimin e shumë kuadrove të rinj si komandant të Katerave Silurues, që më vonë shkëlqyen në këto detyra të rëndësishme. Njihte mjaft mirë detin, anijet, artin e të lundruarit në det, dhe mbi të gjitha njihte njerëzit e aftësitë e tyre! Dhe gjithmonë pati arritje të larta. Komandant Aleko Dede, ky burrë fisnik, bir i Himarës trime e legjendare, njihet për korrektësinë e tij në zbatimin e çdo detyre, komunikimin korrekt me shokët, vartësit dhe eprorët, respektin dhe dashurinë për detin dhe detarët. Ai do mbetet në mendjet e navigatorëve tanë si simbol i thjeshtësisë me shokët dhe këmbëngulës për ngritjen e nivelit tekniko-profesional. Aq i lidhur me detin ishte Komandant Aleko, sa dhe zëri i tij i gërvishur të ngjante me zhurmën e dallgëve kur përplaseshin në breg apo me njëra-tjetrën! Kishte pamje deti me ato rrudhat në ballë si dallgë të detit e të jetës, por gjithmonë i drejtë si Sokrati. Ndaj e donin dhe e respektonin të gjithë detarë e kuadro! Vërtet ai kishte zërin e trashë e të gërvishur, por zemrën, fjalën e komunikimin e kishte të ëmbël, aq sa të dukej se ëmbëlsonte dhe vetë detin! Aleko Dede ishte dhe një kuadër e komandues i aftë. Aleko do mbetet në mendjet e të gjithëve, ai Katranikasi model e i papërtuar në çdo mision. Familja dhe farefisi i tij ka të drejtë të krenohet me jetën dhe veprën e Alekos, këtij prindi, njeriu, miku, shoku e kolegu të mrekullueshëm. Edhe njëherë. Lamtumirë Komandant Aleko Dede! I përjetshëm qoftë kujtimi yt.



Shefqet Kërçelli, Mëhill Marku

Forca Detare zhvillon stërvitje të përbashkët me anijen franceze "BSAM Seine" dhe Forcën Ajrore

Në rajonin e gjirit të Durrësit, me kërkesë të Atasheut Ushtarak francez u zhvillua një stërvitje e përbashkët midis anijes së anti-ndotjes së grupit të dytë të anijeve të Flotiljes Detare me anijen e Forcave Detare të Francës BSAM "Seine".

Pjesëmarrësit në këtë stërvitje ishin anija Franceze "BSAM Seine" A604, anija e klasit "Iliria" P-133 "Lissus", një anije anti-ndotje "Rodoni", si dhe nga Forca Ajrore helikopteri As532 "Cougar".

Gjithashtu, pjesë e angazhimit në stërvitje ishin dhe oficerët të Flotiljes Detare të imbarkuar në bordin e anijes franceze me qëllim shkëmbimin e eksperiencës nëpërmjet veprimeve praktike.

Objektivi kryesor i stërvitjes ishte rritja e nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimeve në zonën e operacionit ndërmjet forcave pjesëmarrëse, zbatimi i proceduarve standardeve kombëtare dhe të NATO-s në kryerjen e operacioneve të mbrojtjes së mjedisit detar, trajnimi dhe stërvitja e ekuipazheve të anijeve për kryerjen e veprimeve praktike.



PREZANTOHET ZËVENDËSKOMANDANTI I FORCËS TOKËSORE

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Detyra e zëvendëskomandantit të Forcës Tokësore është një detyrë me përgjegjësi të lartë, me besim të plotë në kryerjen e detyrave nga gjeneral Dimo, si një ushtarak me eksperiencë dhe formim të lartë profesional

Në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e prezantimit në detyrë të zëvendës komandantit të kësaj njësie, gjeneral brigade Ferdinand Dimo. Prezantimi i tij, u bë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, i cili e vlerësoi gjeneral Dimon si një ushtarak me eksperiencë dhe formim të lartë profesional. "Detyra e zëvendës komandantit të Forcës Tokësore, është një detyrë me përgjegjësi të lartë. Puna në grup, është kara-



teristikë e kësaj Force dhe jam i bindur se zëvendës komandanti juaj i ri, do të dijë të jetë pjesë e këtij grupi", - tha në fjalën e tij gjeneral Begaj.

Nga ana e tij, gjeneral Dimo fillimisht shprehu mirënjohjen personale për lidhshipin politik dhe atë ushtarak, për besimin e treguar me emërimin e tij në këtë detyrë të lartë. Me tej ai e vlerësoi këtë emërim si "rikthim në shtëpinë e vjetër", duke qenë se kohë më parë ai shërbeu në Forcën Tokësore, si shefi i Degës së Ndërlidhjes.



Zhvillohet në Forcën Tokësore konferenca e parë planëzuese për "Biza-22"

Gjeneral brigade Kingji: Konferenca, momenti i duhur për të ofruar të gjitha kapacitetet intelektuale dhe profesionale

Në ambientet e Forcës Tokësore, u zhvillua konferenca e parë planëzuese e stërvitjes "Biza-22".

Fillimi i këtij aktiviteti, u ndoq nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Pjesëmarrës të tjerë në konferencë ishin edhe drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, përfaqësues nga Komandat kryesore dhe repartet autonome të FA.

Gjeneral brigade Kingji, përshëndeti fillimin e konferencës duke e vlerësuar atë si një nga aktivitetet më të rëndësishme, që ka për këtë vit Komanda e Forcës e Tokësore dhe repartet e saj vartëse: "Konferenca, është momenti i duhur për të ofruar të gjitha kapacitetet intelektuale dhe profesionale. Puna në grup dhe produkti që do të dalë nëpërmjet takimeve në sindikata, diskutimeve, ofrimit të njohurive nga ekspertët e fushave specifike, do e përgatisin dhe shtrojnë me së miri rrugën, për të mbërritur tek përbushja me sukses e qëllimit të kësaj stërvitje", - u shpreh ndër të tjera, komandanti i Forcës Tokësore. Qëllimi i kësaj konference, ishte planëzimi dhe marrja e masave tekniko-organizative në lidhje me Grup Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë.



Stërvitja "Biza-22", e cila pritet të zhvillohet në muajin shtator të këtij viti, ka për qëllim përgatitjen dhe testimin e strukturës së Grup Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë (GBKL), për planëzimin dhe zhvillimin e operacionit mësymës, duke aplikuar procedurat standarde të

NATO-s, në një mjedis të përbashkët operacional, për të arritur vlerësimin dhe certifikimin kombëtar të GBKL "Combat Ready", në përputhje me standardet e miratuara, gjatë procesit të planëzimit, ekzekutimit, vlerësimit e analizës së stërvitjes.



Në Forcën Tokësore përfundoi faza e Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA)

Përgjatë një periudhe pothuajse dhjetë javore, trupat që iu nënshtruan Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), nën drejtimin e instruktorëve të Forcës Tokësore, morën njohuri dhe u aftësuan në këto lëndë bazë: përgatitje taktike, përgatitje fizike, përgatitje zjarri, ligjshmëri; edukim mbi vlerat atdhetare dhe patriotike, topografi, mbrojtje nga armët e dëmtimit në masë, përgatitje xheniere etj.

Stërvitja individuale e avancuar, parashikon kalimin në tre faza afësimi: faza e kuqe, blu dhe jeshile. Në të tre këto faza, kursantët kaluan nëpërmjet një trajnimit të rreptë dhe rigoroz, me synimin për të nxjerrë prej tyre aftësitë më të mira. SIA, u zhvillua në dy batalionet e Këmbësorisë të Forcës Tokësore, konkretisht në Batalionin I dhe atë III. Në përfundim të kursit u zhvillua edhe ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve.



EOD, kontribut real në stërvitjen "Ajax Strike" në misionin e Prezencës së Përparuar, Letoni

Kontingjenti i X-të EOD i Komandës Mbështetëse, si pjesë përbërëse e misionit "eFP" Prezenca e Përparuar në Letoni, në kuadër të Aleancës, ka dhënë një kontribut real për eliminimin e rreziqeve që vijnë si pasojë e municioneve në Letoni.

Më konkretisht, pas gjetjes së një predhe artilerie të huaj të kalibrit 120 mm, nga trupat në terren, efektivet EOD të vendit tonë kanë ndërhyrë menjëherë duke bërë të mundur eliminimin e rrezikut nëpërmjet heqjes dhe transportimit të sigurt të municionit, sipas protokollit përkatës. Specifika e këtij misioni ishte gjetur.

Kontributi EOD shqiptar është vlerësuar nga komanda drejtuese e grup-batalionit për efikasitetin dhe profesionalizmin e treguar në realizimin e detyrës së kryer dhe kontributin konkret e tepër të rëndësishëm që jep duke bërë pastrimin e terrenit nga municionet e paplasura e në rastin konkret të një municioni të huaj.



INTERVISTA

Interviste me ish-portierin
e Kombëtares shqiptare
dhe të skuadrës së Partizanit

Legjenda e portës shqiptare PERLAT MUSTA

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve
ANJEZA MUSOLLARI

*Partizani më dha mbiemrin e
madh. Kur erdha fëmijë isha Perlat
dhe kur u rrita u bëra Musta*

Perlat Musta ka lindur në Vlorë, në vitin 1958. Ish-portier i Kombëtares shqiptare dhe i skuadrës së Partizanit. Legjenda e portës shqiptare ka bërë paraqitje të paharrueshme me Kombëtaren shqiptare, ndër të cilat në mendjet e tifozëve të asaj periudhe janë skalitur ndeshjet spektakolare ndaj Gjermanisë, Polonisë dhe takimi i paharrueshëm ndaj Belgjikës. Ai do të mbahet mend si “portieri” i përjetshëm i Partizanit, që nuk e tradhtoi asnjëherë klubin edhe në momentet më të vështira.

Musta ka shërbyer për ngjyrat e Partizanit dhe përfaqësueses shqiptare për më shumë se dy dekada. Futet me ekipin e parë të Partizanit më 1976, për ta mbyllur me 1997, Kampion me fanellën e kuqe më 1979, 1981 dhe 1987 dhe fitues i kupës me 1980, 1991 dhe 1997. Njëkohësisht, ai luajti 23 ndeshje me Kombëtaren nga 1981-1993.

Sot, një legjendë e futbollit shqiptar. Por si ka lindur kjo dëshirë?

Duhet të kem qenë rreth moshës 10-vjeçare kur gjithçka rreth meje lidhej vetëm me futbollin, por ndryshe nga shokët e mi që preferonin të luanin në sulm, mua më pëlqente porta. Edhe pse lojën e portierit e kisha vetëm me imagjinatë, sepse kuptohet në vitet 60’ mungesa e televizorit ishte në çdo familje shqiptare. Pasi mbarova shkollën në qytetin e lindjes u regjistrova në shkollën e Mjeshtërisë Sportive, por nuk arrita të kapja normat, kështu që nuk u pranova. Për hir të së vërtetës prindërit e mi u gëzuan, sepse nuk kishin dëshirë që unë të merresha me sport, pasi kështu ishte psikologjia e asaj kohe.

Ju ishit pjesë e shkollës “Skënderbej”. Si u gjendet aty duke ditur pasionin për futbollin?

Me sugjerimin e prindërve, të

cilët i falënderoj, unë fillova shkollën “Skënderbej”, e cila do të ishte trampolina ime drejt ëndrrës për t’u marrë me futbollin. Aty gjeta një terren shumë favorizues për të ndjekur pasionin tim, pasi siç dihet në ato vite shkolla “Skënderbej” ishte vendi nga ku dilnin sportistët elitë të të gjitha disiplinave. Pra lidhja ime me klubin e Partizanit duket se u shënjua që në atë vit. Shkolla kishte lidhje të ngushta me klubin e Partizanit, dhe sigurisht që favorizonin elementët që spikasnin. Kështu që aty unë rashë në sy dhe në vitin 1976, kur isha 17 vjeç, u aktivizova me të rinjtë e Partizanit për 1 fazë futbollistike. Më pas kalova tek ekipi i parë në vitin 1979. Atë vit Partizani doli edhe kampion, pas një periudhe të gjatë mungese të trofeut në shtëpinë e kuqe. Që në atë kohë, (me një shkëputje të vogël gjatë kohës kur debutova në Rumani me Dinamon e Bukureshtit) e deri në vitin 1997, unë kam luajtur vetëm për ngjyrat e ekipit të Partizanit.”

A mund të na përshkruani rrugën e karrierës suaj?

Unë kam qenë portier i përfaqësueses Shpresa, me të cilën kemi arritur një sukses të madh, siç ishte triumfi në Ballkaniadë. Ne ishim një grup shumë i mirë, që më pas u bashkuam edhe në përfaqësuesen e të rriturve. Unë kam veshur fanellën e kombëtares, më 2 shtator 1981, në një ndeshje ndaj Finlandës, ku bëra një paraqitje të mirë. Më pas kam qenë pjesëtar i kombëtares për shumë vite. Me fanellën kuqezi kam zhvilluar 23 ndeshje ndërkombëtare. Përfaqësuesja më ka dhuruar shumë emocione, sidomos në ato ndeshje të famshme ndaj Gjermanisë. Polonisë me të cilën

barazuam 2-2 dhe sigurisht që mbetet e paharruar ndeshja ndaj Belgjikës së Shifos së madh, ku ne fituam 2-0.

Mbresa më ka lënë dhe përballja me Sëlltikun për kupën e kampioneve. U paraqitëm shumë mirë në “Qemal Stafa”. Në Britani u vumë nën presionin e skocezëve.

Duhej të vinin eliminatorët e 82-it. Në ekipin kombëtar Jani Kaçi ishte portier i parë. Pas humbjes 5 me 0, largohet Zyber Konçi dhe Loro Boriçi merr drejtimin e kombëtares.

Më 2 shtator debutoj me kombëtaren ndaj Finlandës. Transformohem si titullar i padiskutueshëm deri në vitin 1987.

Çfarë mbani mend nga takimet ndërkombëtare që keni luajtur, cili ju ka lënë më tepër mbresa?

Kam luajtur disa herë me Gjermaninë, skuadër e cila kishte qenë disa herë kampione bote dhe Europe, me lojtarë të mëdhenj si Rumenige, Shumaker etj. Ishte kënaqësi dhe krenari të luaje përballë emrave të tillë, sepse kisha mundësinë të tregoje diçka nga vetja jote. Më pas kanë qenë polakët me Bonjek, austriakët etj. Në 33 ekipe të asaj kohe të Europës, vetëm 7-8 ekipe mund të ishin të nivelit të dobët.

Kombëtarja jonë kishte mundësinë për të arritur në finale të botërorit. Përse nuk u arrit kjo?

Ishte periudha në eliminatorët e viteve 84-85, në botërorin e Meksikës, ne patëm një moment të mirë të cilin nuk e shfrytëzuam dot për shumë arsye, e para sepse nuk ishim përgatitur psikologjikisht; e dyta, ne shkonim luanim pa bërë asnjëherë një ndeshje miqësore; dhe e treta, në përballje kishim skuadrat e Polonisë



dhe Belgjikës të nivelit të lartë. Njëra ishte nën kampione, tjetra doli nën kampione. Patëm dhe një përballje me Greqinë që nuk hynte tek skuadrat e forta, por ne nuk mundëm të merrnim pikë. Shkak ishin disa faktorë, mbase jo dhe teknikë sesa fat, që nuk na mundësuan sjelljen e një trofeu kaq të rëndësishëm në Shqipëri.

Lojtari që ia kishit “frikën” kur i afrohej portës suaj?

Frikë asnjëherë, respekt kam pasur për të gjithë sulmuesit.

“Me një portier të mirë, në një ekip të dobët mund ta fitosh ndeshjen, ndërsa me një ekip të mirë por me portier të dobët e humbet takimin” (Levi Ashin). A ishte kjo motoja juaj?

Kjo tregon rolin dominant që ka portieri. Padyshim që kjo ka qenë mjaft e rëndësishme për mua, dhe kështu duhet të jetë për të gjithë



portierët e skuadrave.

“Partizani i Perlat Sulës apo Perlat Sula i Partizanit?”

Me Partizanin kam fituar 4 kampionate dhe 3 Kupa Republike, çka do të thotë se kam marrë me të vërtetë shumë sadsifaksion. Publiku na ka mbështetur vazhdimisht dhe ende kujtoj me nostalgji shkallët e stadiumeve plot, ku nuk shikoje një vend bosh. Rivaliteti mes skuadrave në ato vite ka qenë realisht shumë i madh dhe niveli i futbollit, bënte që njerëzit të na ndiqnin ngado, ndonëse kushtet ekonomike ishin shumë të disfavorshme. Partizani është familja ime ku u rrita profesionalisht dhe sot së bashku krenohemi për çfarë kemi mundur të arrijmë. Në moshën 17-vjeçare kaloj

te ekipi i Partizanit, i cili drejtohej nga emra të njohur, si Refik Resmja dhe Panajot Pano.

Në portë titullar ishte Jani Kaçi, por pas përfundimit të shërbimit ushtarak, ai kthehet në Korçë tek Skënderbeu. U afruan portierë të tjerë, ndërsa unë isha gjithnjë rezerve.

Stërvitesha tre herë në ditë. Ndërkohë më duhej të zgjojohesha edhe në 2 të natës nga alarmi i stërvitjes ushtarake. Për sezonin e ri Mikel Janku vendosi veton. Më mbajti në ekip dhe luaj ndeshjen e parë me Partizanin si titullar ndaj Lushnjës, të cilën e fitojmë.

Partizani më dha mbiemrin e

madh. Kur erdha fëmijë isha Perlat dhe kur u rrita u bëra Musta.

Cili ka qenë trajneri juaj i parë?

Trajneri im i parë ka qenë Sherif Çiçiku, për të cilin ruaj konsideratat e mija më të mira. Është shumë e rëndësishme të kesh një “mësues” që e dashuron punën e tij, sepse dhe ty si “nxënës” të kalit dëshirën për të arritur majat vetëm me punë. Këtë përpiqem tu them dhe të rinjve tanë sot.

Momenti i kapjes së topit që e kujtoni dhe sot?

Edhe sot e kujtoj, luanim ndaj Benfikës në kupën e Kampioneve, në pjesën e dytë kap një top me planzhon. Lojtari kundërshtar bie mbi mua. Kur ngrihem, gjyqtari më jep karton të verdhë. I buzëqesha me ironi sepse ishte absurditet.

Si u gjendët në skuadrën rumune?

Në fillimin e viteve '90 rrugët ishin hapur. Në këtë kohë erdhi momenti për të provuar vlerat jashtë kufijve të Shqipërisë. Partizani luajti me rumunët e Krajovës në Europë. Drejtuesit filluan të lidhnin kontakte. Ata kërkuan shërbimet e mia. Por nuk bëhem pjesë e Krajovës, sepse Dinamo e Bukureshtit këmbënguli në formën e vet. Mua, Demollarin dhe Arben Mingën na kërkuan të firmosnim me Dinamon. Luajta atje për tre vite.

Perlat Sula si trajner?

Çdo fillim e ka një fund. Në ndeshjen ndaj Tomorit pësoj dëmtim në gju. Ky ishte fundi i karrierës si futbollist, por kurrë jashtë fushës së gjelbër, ajo është oksigjeni im.

Për herë të parë në Shqipëri solla idenë e trajnerit të portierëve, koncept që nuk ekzistonte më parë. Ishim mësuar që trajneri i parë të stërviste të gjithë skuadrën së bashku. Stërvita shumë portierë duke ndjekur gjithnjë një parim.

“Trajneri i mirë është ai që tregon rrugën e drejtë dhe portieri i mirë është ai që kupton rrugën dhe korrigjohet.”

Jo me të gjithë portierët ka funksionuar kjo teori, por me një pjesë ka dhënë rezultate shumë të mira. Selmani ishte vetëm 5 vjeç kur e stërvita. Kishte talent që në atë moshë. Sot Selmani është portieri më i kompletuar në kombëtaren shqiptare. Për mua ai duhet të jetë



titullari i portës.

Çfarë profesioni do të zgjidhnit nëse nuk do të ishit futbollist?

Ky është pasioni dhe profesioni që kam ëndërruar prej fëmijërisë së largët. Dola kundër prindërve sepse e doja, dhe nëse diçka e do fort dhe përpiqesh ta ushqesh me dashurinë e duhur, nuk ka forcë që e ndal.

Kuriozitet kemi për golin që ju i dhuroat kinezëve? Si ndodhi?

Ka qenë një episod mjaft interesant, kur pata rastin të mbroj portën e ekipit të të rinjve të Partizanit, në një ndeshje me një ekip kinez, në kuadër të “miqësisë” mes dy vendeve që ekzistonte në atë kohë. Në pjesën e parë ne kryesonim me rezultatin e thellë 5-0. Në pushim të ndeshjes, na u tha që duhet të tregoheshim më “bujarë” me miqtë dhe “nderi” më takonte mua, meqenëse unë do të isha portier në pjesën e dytë. Si përfundim, kinezët mundën të shën-

onin 2 gola, ndërkohë që pas disa kohësh, miqtë më thanë se ata gola të pësuar u panë nga “specialistët” si një dobësi e imja. E ku ta dinin ata se ne ua dhuroam haptazi golat!

Futbolli dje dhe sot? Si ju duket të rinjtë tanë në fushën e gjelbër?

Dikur futbolli luhej jo vetëm me këmbë, por me shpirt dhe mendje. Pra gjithçka behej duke kalkuluar situatën që kishe përpara. Sot i përdorin këmbët por jo ndjesitë. Por të rinj të talentuar kemi dhe me punën e tyre unë besoj se e ardhmja do jetë dhe më e ndritur

Në fillesat tona gjithmonë kemi nevojë për dikë që të na mbështesë dhe për të cilin jemi falënderues në gjithë ciklin e jetës. Po ju kujt ia adresoni falënderimet tuaja?

I jam mirënjohës dhe falënderues klubit të madh Partizani për gjithçka që më ka dhënë.

Përfundimi dhe Certifikimi i Kursit të Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi



Mbyllet me sukses kursi i Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, në specialitetet Këmbësori dhe Ndërlidhje. Në këtë ceremoni morën pjesë dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë Kolonel Flamur Hadushi, shefa departamentesh të AFA-së, instruktorë përgjegjës të QAPU-së dhe kursantët e SIA-s. Në fjalën e tij përshëndetëse dekani i FMS Kolonel Hadushi, përshëndeti dhe uroi kursantët që përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale për rezultatet e arritura në të gjitha

disiplinat e programit stërvitor 10 javor. Ai i përcolli edhe përshëndetjet e Komandantit të AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, për këtë ditë të shënuar në karrierën e tyre ushtarake. Gjithashtu dekani i FMS-së në fjalën e tij u ndal dhe në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë ushtarake të krijuar deri tani dhe i motivoi kursantët që të vijojnë pasurimin e karrierës së tyre me kurse të tjera për të shërbyer edhe si nënoficerë në FA. Në këtë kurs u certifikuan 57 ushtarë/detarë të I-rë, të cilët përfitojnë gradën ushtar/detar i II-të.



KOMANDA MBËSHTETËSE

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Lidhja e zonave rurale nëpërmjet urave "Bailey", tregues mbështetjeje në çdo situatë krize

Pas një pune prej më shumë se një jave, si pasojë e amortizimit të urës së vjetër të zonës, xhenierët e kompanisë së urave të Komandës Xheniere kanë përfunduar me sukses ndërtimin e urës xheniere tip "Bailey" në fshatin Shebë, njësi administrative Kthellë të bashkisë Mirditë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Hajdar Gurra si dhe zëvendëskryetarja e bashkisë Mirditë znj. Vitore Gjini.

Komandanti i KM, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia gjatë fjalës së tij falënderoi efektivin e Kompanisë së Urave dhe u shpreh se: "Lidhja e zonave rurale nëpërmjet urave "Bailey", që ndërtojnë xhenierët e Komandës Mbështetëse janë një tregues i mbështetjeje në çdo situatë krize për popullsinë në nevojë, mbështetje e cila do të vijojë. Ndërtimi i kësaj vepre prej 18 m, e me peshëmbajtje 40 ton është një kontribut tepër i rëndësishëm për lidhjen e komunitetin e kësaj zone, ndaj ju falënderoj sot për punën e palodhur dhe ndërtimin e kësaj ure, e cila nuk është e vetmja pasi kjo kompani vijon punimet edhe në qytetin e Pukës."

Nga ana e saj znj. Gjini falënderoi forcat xheniere dhe gjeneral brigade Ilir Xhebexhinë për mbështetjen nga Forcat e Armatosura në ndërtimin e kësaj vepre në kohë rekord, e cila shërben në interes të rreth 1000 banorëve të fshatrave Shebë, Malaj dhe Trojes, në lidhjen e komunikimit për shërbimet e nevojshme në jetën e përditshme, ekonominë dhe mos shpopullimin e zonës.



● Ndërtimi i kësaj vepre prej 18 m, e me peshëmbajtje 40 ton është një kontribut tepër i rëndësishëm për lidhjen e komunitetin e kësaj zone, ndaj ju falënderoj sot për punën e palodhur dhe ndërtimin e kësaj ure, e cila nuk është e vetmja pasi kjo kompani vijon punimet edhe në qytetin e Pukës

Rumania i bashkohet kornizës më të suksesshme të bashkëpunimit të NATO-s për municionet

Projekti me dukshmëri të lartë, Municionet Decisive të Betejës Ajrore të NATO-s (ABDM), mirëpriti Rumaninë si pjesëmarrësin e saj të pesëmbëdhjetë. Në prag e Takimit të Takimi i Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, në Bruksel, u zhvillua një ceremoni nënshkrimi, e udhëhequr nga Mircea Geona, zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Nikolaos Panagiotopoulos, ministri i Mbrojtjes i Greqisë dhe Vasile Dîncu, ministri i Mbrojtjes i Rumanisë. Ministrat e Mbrojtjes në Bruksel.

Nisma ABDM u ka dhënë aleatëve akses në municione kritike të lëshuara nga ajri në kushte më të favorshme që nga fillimi i saj në 2014. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha: "ABDM

e ka mbajtur tashmë këtë premtim që nga viti 2018. Përmes strategjive novatore të blerjes, pjesëmarrësit kanë reduktuar koston e tyre për municione të drejtuara me saktësi me 15 deri në 20 për qind. Në përgjigje të kërkesave urgjente operacionale, ata ishin në gjendje të shkurtonin afatet kohore të dorëzimit deri në një vit. Në të njëjtën kohë, ata përmirësuan ndjeshëm ndërveprueshmërinë dhe ndarjen e stoqeve të tyre, duke i bërë trupat e NATO-s një forcë më të unifikuar në operacione". Rumania zyrtarisht iu bashkua pjesëmarrësve të tjerë - Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar.



Takimet e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s

Deklarata e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s për situatën në dhe rreth Ukrainës

Në jemi shumë të shqetësuar nga ngritja ushtarake ruse në shkallë shumë të madhe, të paprovokuar dhe të pajustificuar në dhe rreth Ukrainës dhe Bjellorusisë. Ne i bëjmë thirrje Rusisë, në termat më të fortë të mundshëm, të zgjedhë rrugën e diplomacisë dhe të ndryshojë menjëherë ngritjen e saj dhe të tërheqë forcat e saj nga Ukraina në përputhje me detyrimet dhe angazhimet e saj ndërkombëtare. Ne mbetemi të përkushtuar ndaj qasjes sonë të dyfishtë ndaj Rusisë: parandalim dhe mbrojtje e fortë, e kombinuar me hapjen ndaj dialogut.

Veprimet e Rusisë përbëjnë një kërcënim serioz për sigurinë euroatlantike. Si pasojë dhe për të garantuar mbrojtjen e të gjithë aleatëve, ne po dislokojmë forca shtesë tokësore në pjesën lindore të Aleancës, si dhe mjete shtesë detare dhe ajrore, siç njoftuan aleatët, dhe kemi rritur gatishmërinë e forcave tona. Masat tona janë dhe mbeten parandaluese, proporcionale dhe de-shkallëzuese. Ne jemi të përgatitur të forcojmë më tej qëndrimin tonë mbrojtës dhe parandalues për t'u përgjigjur të gjitha situatave të paparashikuara.

Angazhimi ynë ndaj nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit është i veshur me hekur. Ne jemi të bashkuar për të mbrojtur njëri-tjetrin.

NATO mbetet e përkushtuar ndaj parimeve themelore që mbështesin sigurinë evropiane, duke përfshirë se çdo komb ka të drejtën të zgjedhë aranzhimet e veta të sigurisë. Ne riafirmojmë mbështetjen tonë për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Siç u tha më parë, çdo agresion i mëtejshëm rus kundër Ukrainës do të ketë pasojë masive dhe do të ketë një çmim të lartë. NATO do të vazhdojë të koordinohet ngushtë me palët përkatëse të interesit dhe organizata të tjera ndërkombëtare, përfshirë BE-në.

NATO dhe Aleatët vazhdojnë të ndjekin diplomacinë dhe dialogun me Rusinë për çështjet e sigurisë euroatlantike, duke përfshirë në nivelet më të larta. Ne i mbështesim të gjitha këto përpjekje dhe përpjekjet në Formatin e Normandisë për të zbatuar marrëveshjet e Minskut. Ne kemi shprehur gatishmërinë tonë për t'u angazhuar në një Dialog të Rinovuar të Sigurisë Europiane të iniciuar nga Polonia si kryesues aktual i OSBE-së. Ne i kemi bërë propozime thelbësore Rusisë për të rritur sigurinë e të gjitha kombeve në rajonin euroatlantik dhe presim një përgjigje. Ne vazhdimisht kemi ofruar dhe vazhdojmë të ofrojmë dialog të mëtejshëm përmes Këshillit NATO-Rusi dhe jemi të gatshëm të angazhohemi. Ne inkurajojmë fuqishëm Rusinë që të reagojë dhe të zgjedhë diplomacinë dhe de-përshkallëzimin.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se në ditën e parë të takimeve të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në Bruksel, u takuan për të trajtuar forcimin e vazhdueshëm ushtarak të Rusisë në dhe rreth Ukrainës.



"NATO mbetet e përgatitur për dialog, -tha Sekretari i Përgjithshëm. -NATO i ka dërguar Rusisë propozime konkrete me shkrim për transparencën, reduktimin e rrezikut dhe kontrollin e armëve. Nuk kemi marrë ende një përgjigje. E përsëris ftesën time drejtuar Rusisë për t'u takuar sërish në Këshillin NATO-Rusi. NATO nuk do të bëjë kompromis mbi parimet thelbësore; e drejta e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e vet dhe aftësia

jonë për të mbrojtur dhe mbrojtur të gjithë aleatët", -theksoi ai. Sekretari i Përgjithshëm tha se ministrat mirëpritën gjithashtu përparimin e bërë në ndarjen e barrës, me vitin e shtatë radhazi të rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes nga Aleatët Evropianë dhe Kanadaja.

Në selinë e NATO-s, përpara takimeve të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, i pranishëm ishte edhe Sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd Austin, i cili u prit nga Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg.

UKRAINA KËRKON NDIHMË NDERKOMBËTARE PËR EMERGJENCAT NË SHKALLË TË GJERË TË NATYRAVE TË NDRYSHME

NATO vazhdon përpjekjet e saj për të rritur qëndrueshmërinë e Ukrainës

Shërbimi Shtetëror i Emergjencave të Ukrainës po përgatitet për emergjencë në shkallë të gjerë të natyrave të ndryshme që mund të prekin popullsinë e saj civile. Në përputhje me procedurat në referencë, EADRCC ka marrë më 15 shkurt 2022, një kërkesë për ndihmë ndërkombëtare nga Ukraina. NATO dhe Ukraina mbajtën një seminar mbi qëndrueshmërinë kombëtare në selinë e NATO-s në Bruksel. Seminari mblodhi së bashku ekspertë nga vendet aleate dhe Ukraina për të diskutuar dhe ndihmuar në forcimin e Sistemit Kombëtar të Rezistencës së Ukrainës. Kjo është pjesë e bashkëpunimit më të gjerë dhe afatgjatë të NATO-s me Ukrainën në fushën e elasticitetit. Me kërkesë të Ukrainës, NATO ofron këshilla teknike për të mbështetur elasticitetin afatgjatë të vendit dhe aktivitetet e gatishmërisë civile. Një Ekip Mbështetës Këshillimor i NATO-s për Qëndrueshmërinë, i miratuar nga Komiteti i Planifikimit të Emergjencave Civile të NATO-s dhe i përbërë nga ekspertë nga vendet aleate, aktualisht po mbështet zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Rezistencës së Ukrainës. Punimet dyditore u fokusuan në ofrimin e rekomandimeve që Ukraina duhet të çojë përpara. Zëvendës ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i Divizionit të Politikave dhe Planifikimit të Mbrojtjes, Z. Jörg See tha: "Ukraina ka bërë një rrugë të gjatë në ndërtimin e një sistemi kombëtar të qëndrueshmërisë dhe mbështetjen e strukturave nga themeli. Në këtë kontekst, zbatimi i ardhshëm i ligjeve të reja për Infrastruktura Kritike, Mbrojtjen Territoriale dhe, natyrisht, të Konceptit të Sistemit Kombëtar të Rezistencës do të forcojë gatishmërinë e Ukrainës për t'u përgjigjur dhe për t'u rikuperuar nga tronditja, stresi dhe befasia.

Jens Stoltenberg: Ka shenja nga Moska se diplomacia duhet të vazhdojë, kjo është bazë për optimizëm të kujdesshëm

Në një konferencë për shtyp, para ministerialit të Ministrave të Mbrojtjes Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg deklaroi se ka shenja nga Moska se diplomacia duhet të vazhdojë, duke thënë se kjo "është bazë për optimizëm të kujdesshëm".

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se nuk ka asnjë indikacion për ndonjë de-përshkallëzim në terren. "Rusia ka grumbulluar një forcë luftarake në dhe rreth Ukrainës, e paprecedentë që nga Lufta e Ftohtë. Tani gjithçka është në vend për një sulm të ri, por Rusia ka ende kohë të tërhiqet nga pragu", -tha Stoltenberg, duke i kërkuar Rusisë të ndalojë përgatitjen për luftë dhe të fillojë të punojë për një zgjidhje paqësore të krizës.

Në lidhje me deklaratën e përbashkët të Kinës dhe Rusisë, në fillim të Lojërave Olimpikë, pyetjes se a duhet të trajtohet tani Rusia dhe Kina së bashku, Sekretari i Përgjithshëm iu përgjigj se: "NATO duhet t'i përgjigjet realitetit. Dhe realiteti është se Kina dhe Rusia janë afuar gjithnjë e më shumë gjatë viteve të fundit. Ata janë duke ushtruar së bashku. Ata po punojnë më ngushtë së bashku në fushën diplomatike në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, por gjithashtu kemi veje re se si ata kryejnë gjithnjë e më shumë stërvitje gjatë viteve të fundit, duke përfshirë kohët e fundit një stërvitje të përbashkët me Iranin në Oqeanin Indian. Pra, këto janë realitete që kanë ndodhur gjatë njëfarë kohe dhe ato ndikojnë në sigurinë tonë, nuk ka asnjë mënyrë që ta mohojmë, ose të mos e marrim parasysh këtë. Dhe kjo është pikërisht ajo që NATO ka bërë gjatë viteve të fundit, veçanërisht që nga Samiti ynë verën e kaluar, ku ne për herë të parë patëm një gjuhë thelbësore mbi pasojat e sigurisë të Kinës për sigurinë tonë. Por ne jemi gati të angazhohemi edhe me Kinën. Ne kemi nevojë për dialog, ne duhet të trajtojmë kontrollin e armëve, çështje të mëdha si ndryshimi i klimës dhe shumë çështje të tjera. Dhe pikërisht këtë po bëjmë. Por duke e ditur se, për shembull, Kina tani po zhvillon me shpejtësi aftësi të reja bërthamore, raketa me rreze të gjatë, raketa hipersonike, sigurisht që ka rëndësi... dhe raketa që mund të arrijnë të gjithë territorin e NATO-s. Nuk ka asnjë mënyrë që ne të mos e marrim parasysh këtë, sepse ne shohim se Kina po na afrohet më shumë në hapësirën kibernetike, në Arktik, në Afrikë dhe gjithashtu po përpiqet të kontrollojë infrastrukturën kritike. Mendoj se ajo që në thelb shohim është se dy fuqi autoritare, Rusia dhe Kina, po veprojnë së bashku. Sepse kjo nuk i përshtatet rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ata nuk ndajnë vlerat tona, lirinë, demokracinë. Dhe kjo është gjithashtu arsyeja pse ata u përpoqën t'u mohonin kombeve sovraane, demokratike të drejtën për të zgjedhur të ardhmen e tyre. Ata duan një botë ku fuqitë e mëdha mund të vendosin se çfarë mund të bëjnë fuqitë dhe vendet më të vogla. Pra, kjo ka të bëjë me parimet themelore, nëse vendet e lira dhe të pavarura mund të zgjedhin të jenë pjesë e një aleance si NATO ose mund të zgjedhin të qëndrojnë jashtë. Duhet ta respektojmë gjithsesi. Dhe NATO respekton vendimet sovraane, demokratike të Finlandës dhe Suedisë për të mos aplikuar për anëtarësim ose nga Ukraina për të aplikuar për anëtarësim. Këto janë vendimet e tyre sovraane, demokratike dhe ne i respektojmë ato. Por Rusia dhe Kina nuk e bëjnë këtë. Ata kanë thënë qartë në një deklaratë të përbashkët se nuk duan që vendet në botë ta kenë atë liri, të marrin vendimet e tyre për të ardhmen e tyre. Dhe kjo thjesht tregon një ndryshim thelbësor kur bëhet fjalë për vlerat dhe se në çfarë lloj bote do të dëshironim të jetonim. Unë do të doja të jetoja në botën ku kemi kombe të lira, demokratike që jetojnë në një botë me një rend botëror. Dhe aty ku duhet t'i përmbahemi shtetit të së drejtës, jo sferat e ndikimit ku fuqitë e mëdha vendosin se çfarë mund të bëjnë fqinjët.

Konflikti në Ukrainë, drejt "racionalitetit" apo "çmendurisë"?



Kolonel HYSNI GJERGJI,
Shef Grupi IKSHU

Përfundimi i luftës së ftohtë në 1991, shpërbërja e Traktatit të Varshavës dhe rënia e murit të Berlinit, për shumë studiues ushtarakë dhe të gjeopolitikës, u deklarua edhe si fundi i misionit të NATO-s. U hodhën ide edhe për shpërbërje, pasi aleancës së Atlantikut të Veriut i mungonte blloku ushtarak armik, apo një shtet kërcënues për sigurinë e anëtarëve të saj. Por sulmi në Gjeorgji dhe pushtimi i Krimesë në 2014, treguan që kërcënimi rus (sovjetik) ishte rizgjuar. Këto fakte vazhdojnë të bindin çdo ditë e më shumë të gjithë skeptikët, që NATO është e domosdoshme, aleanca është në misionin e saj të duhur dhe historik edhe sot në 2022. Rusia në strategjinë e sigurisë kombëtare të saj deklaroi se NATO-ja vazhdon të etiketohet si fuqia kryesore armike e sigurisë kombëtare të Rusisë, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe perëndimi, iu propagandohen qytetarëve rusë si shkatërrarët e vetëm të varfërisë dhe rënies së tyre ekonomike.

Por a do të ketë luftë në Ukrainë? Ka vetëm një njeri në planet, i cili mund ta dijë me siguri këtë përgjigje që është Vladimir Putin. "Kjo përgjigje varet nga versioni i liderit rus që ne zgjedhim të besojmë dhe i cili do të marrë vendimin: Një "Putin Racional" apo një "Vladimir i Çmendur". A do të jetë Ai lider i luftës apo strateg i paqes", -shkruan për "Financial Times", Gideon Rachman. Shumë politikë-bërës perëndimorë besojnë tek "Putini Racional" pasi argumentojnë dhe besojnë se pas më shumë se 20 vjetësh në pushtet, lideri rus është i njohur për sjelljet dhe taktikat e tij racionale dhe të zgjuara. Të tjerë që besojnë në "Vladimirin e Çmendur", nisen nga fakti i fundit i liderit rus për botimin e eseve dhe retorikave me frymë nacionaliste. Në korrik 2021, ai shkroi mbi: "Unitetin historik të rusëve dhe ukrainasve", dhe një ese mbi "Origjinën e Luftës së Dytë Botërore", duke pretenduar se Britania dhe Franca, kishin inkurajuar qëllimisht Gjermaninë të sulmonte Bashkimin Sovjetik. Ata që besojnë tek "Putini Racional", argumentojnë se udhëheqësi rus, ka më shumë gjasë të ndër-marrë veprime të kufizuara ushtarake, vetëm në Ukrainën Lindore, ku po zhvillohet nga 2014 një konflikt i nivelit të ulët midis ushtarisë ukrainase dhe forcave pro-ruse në Donetsk. Putin nuk është bankier, filozof, profesor universiteti apo ekonomist. Profesionin dhe biznesin e tij ai ka luftën, pasi është arsimuar, trajnuar dhe stërvitur si ushtarak si dhe ka pasur karrierë në kundërspiunazhin rus, gjatë luftës së ftohtë. Ai njih shumë mirë historinë e luftërave të mëparshme, ndërsa në Luftën e ftohtë ka qenë një drejtues i inteligjencës ruse në Gjermaninë Lindore. Lufta e ftohtë dhe ngjarjet e saj i kanë dhënë një përvojë të konsiderueshme atij, dhe kjo duket në mënyrën sesi ai po drejton superfuqinë ruse.

Situata kërcënuese e Kremlinit kundër Kievit sot po zë faqen kryesore të shtypit ndërkombëtar, si dhe aktivitetin diplomatik të organizmave



ndërkombëtare NATO, BE dhe OKB. Kjo paraqitet para popullit rus si një arritje e Moskës, pasi gjithë bota i ka sytë dhe vëmendjen tek Rusia duke e rivlerësuar fuqinë dhe rolin e saj si superfuqi edhe një herë tjetër pas disa dekadash. Pikërisht edhe në këtë fillim viti të 2022 situata ngjan si para 60 viteve, gjatë luftës së ftohtë. Sot shtetet në konflikt nuk janë thjesht Rusi - Ukrainë, por Rusia përballë SHBA-së dhe NATO-s, ku palët janë posedues edhe të armëve bërthamore. Ky fakt e bën konfliktin të ngjashëm, shumë të rrezikshëm nëse ndodh, si dhe "jo racional" për hir të shkatërrimit të paimagjinueshëm që do të arrihej nëse do të përdorehin këto armë.

"Pushtim" është fjala më e përdorur prej më shumë se një muaji në të gjitha mediat dhe deklaratat e liderëve botërorë. Pushtimi në terma ushtarakë dhe gjeopolitikë, nënkupton marrjen nën kontroll ushtarak të një shteti sovran nga një shtet tjetër. Sipas historisë, luftërat kanë filluar, janë ndërprerë dhe kanë përfunduar në tavolinat e politikës, pas fushatave ushtarake apo pas marrëveshjeve diplomatike "Luftërat mund të bëhen nga armët, por ato fitohen nga njerëzit" -shkruan Gjenerali George Patton. Historia e largët por edhe e afërt e luftërave, na mëson se sa e vështirë është marrja nën kontroll e një populli dhe një territori të caktuar me mjete të pastra luftarake dhe kryesisht me "fuqi të ashpër". "U deshën 20 vjet angazhim ushtarak, trilionat dollarë të shpenzuar, katër presidentë dhe mijëra jetë të humbura nga ana e SHBA-së, për të ndryshuar regjimin në Afganistan: nga taleban në taleban", -shkruan me sarkazëm "The Economist". Në Ukrainë popullsia po përgatitet për luftë, përfshirë gra dhe fëmijë duke u stërvitur për të mbrojtur atdheun e tyre. Kjo ndërjegje e rezistencës popullore është shumë here më e rëndësishme dhe e pathyeshme, se sa tanket dhe raketat të komanduara nga ushtarakë rrogëtarë, që po sulmojnë një vend sovran. "Forca e mureve të kështjellës, është sa guximi i atyre që i mbrojnë këto mure", -na mëson Genghis Khan nga shekulli i XII-të. Sigurisht "Putini racional" i ka studiuar shumë mirë këto leksione, dhe kurrsesi nuk do dëshironte të kishte fatin e të ngjashmëve të tij të mëparshëm. Putin është mjeshtrë i teorisë dhe praktikës së luftës hibride, i gërshetimit të luftës politike, diplomatike, ushtarake dhe informative. Në të gjithë Europën, pa përjashtim, Putin po drejton atë që di të bëjë më mirë: luftën me kibernetikë, kërcënim ekonomik për bllokim të furnizimit me

gaz të Europës, spiunazh, sabotazh dhe subversion të nisur që nga lufta e ftohtë. "Moska është përpjekur të minojë institucionet demokratike të Ukrainës, ka ndërhyrë në politikën e brendshme dhe zgjedhjet e Ukrainës, ka bllokuar energjinë dhe tregtinë për të frikësuar dhe shantazhuar, ka përdorur propagandën dhe keqinformimin, për të mbjellë mosbesim si dhe ka ndër-marrë sulme kibernetike", -deklaroi Sekretari i SHBA-së Blinken, më 1 shkurt 2022. Së fundmi, më 9 shkurt 2022 institucionet bankare europiane dhe botërore alarmohen nga një sulm i mundshëm i koordinuar i hakerave rusë në sistemin monetar ndërkombëtar.



Është tashmë e vërtetuar, se Moska ka përdorur dhe po përdor ndërhyrjet në zgjedhjet politike të vendeve të ndryshme, me qëllim manipulimin e procesit politik të zgjedhjeve në Europë, SHBA dhe Ballkan, duke mbështetur personalitete pro-ruse.

Në dhjetor të 2021, teksa trupat ruse ishin të grumbulluara pranë kufirit të Ukrainës, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky paralajmëroi vazhdimisht mbi rrezikun e një grushti të mundshëm shteti në Kiev, të planifikuar nga Moska dhe oligarkët pro-rusë në Ukrainë. Qëllimi i këtij grushti shteti do të jetë vendosja e një qeverie të

re pro-ruse në Ukrainë, e cila do kishte të drejtë të kërkonte zyrtarisht për ndërhyrje forcat e CSTO-së, siç ndodhi në Kazakistan. Kërkesa e një qeverie qoftë edhe "të përkohshme" për ndërhyrje nga jashtë do të sigurote sado pak legjitimitet për të filluar një proces pushtimi nga brenda të Ukrainës duke bërë anëtarësim të saj në CSTO.

Ministria e jashtme britanike, më 6 shkurt 2022, deklaroi se ka informacione në lidhje me kontaktet ndërmjet shërbimeve sekrete ruse me katër personalitete të tjera politike të Kievit, ish-kryeministri Mykola Azarov, ish-zëvendëskryeministrat, Serhiy Arbutov dhe Andriy Kluyev, si edhe ish-zëvendëshefi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Vladimir Sivkovich, të cilët kanë qenë të gjithë në detyrë në kohën e presidentit të konsideruar pro rus, Viktor Yanukovich, larguar nga pushteti në vitin 2014. Kandidati për kryeministër i mbështetur i Moskës në Ukrainë është ish-deputeti, Yevhen Murayev. "Presioni dhe qëllimi për të fituar pa luftë, por nëpërmjet demonstrimit të fuqisë së armëve dhe ndërhyrjes nga brenda, ka qenë synimi i të gjithë luftërave", -shkruan Sun Tzu tek Arti i Luftës.

Në fund të këtyre analizave arrihet në përfundimin që: nuk do të ketë një "pushtim" nga jashtë vetëm me "fuqi të ashpër", ose një luftë konvencionale në Ukrainë, por nëse ndodh rezultoni të jetë vetëm një luftë lokale, hibride dhe duke përdorur fuqinë "smart" si kombinim të fuqisë "hard" dhe "soft".

Një leksion tjetër që na jep historia e luftërave është se, shtetet nuk do të sulmojnë njëri-tjetrin, vetëm atëherë kur të arrihet ekuilibri me trupa dhe armata dhe palët do të përpiqen të ruajnë "status quo" -në aktuale. "Faktorët që çojnë në fitoren e një lufte, -shkruan Sun Tzu tek "Arti i Luftës", -janë planifikimi, numri i ushtarëve,

logjistika, dhe balanca e fuqisë; dhe në fund fituesin e vendos Balanca e Fuqisë". Balanca e fuqisë është politikë e një shteti ose grupi shtetesh që mbrohet kundër një kombi ose grupi kombesh të tjera, duke e krahasuar fuqitë mes palëve.

Politikën e ekuilibrit të fuqisë, shtetet mund ta ndjekin e zhvillojnë në dy mënyra:

- Duke rritur fuqinë e tyre ushtarake dhe ndjekur garën e armatimit;
- Duke i shtuar fuqisë së tyre edhe fuqitë e shteteve të tjera, përmes një politike diplomatike dhe aleancash.

NATO dhe SHBA po afron trupa dhe



teknologji ushtarake në vendet anëtare të saj, pikërisht për të vendosur këtë ekuilibër fuqie me ushtrinë ruse të dislokuar në Rusi dhe Bjellorusi, dhe pamundësuar epërsinë numerike ruse.

Një leksion me përmasa botërore që po rilexojmë këto ditë të ftohta rreth luftës së ftohtë, është "Doktrina e shkatërrimit të sigurt të palëve luftuese", (Mutual assured destruction), e cila, në vitet 60-të pas krizës së raketave ruse bërthamore në Kubë, parandaloi sulmin e sigurt vdekjeprurës nga të dyja palët SHBA-BR. Në kërcënimin aktual, përveç Rusisë edhe Bjellorusia deklaroi se është gati të lejojë armët bërthamore ruse në kufirin dhe territorin e saj. Për balancë parlamenti sllovak, më datë 9 shkurt, vendos të pranojë në territorin e saj trupat dhe armët konvencionale të SHBA-së dhe NATO-s, përfshirë ato bërthamore.

Nëpërmasë garës së armatimit dhe të "Deterrence by Presence", midis fuqive kundërshtarë para 60 viteve, u arrit që të ruhej "Balancim i Fuqisë" midis tyre, që kishte të bënte kryesisht me barazimin në numra, në aftësi luftarake dhe lloje armatimit, që dy aleancat përballë dispononin. Sot aktualisht në Kufirin Rusi-Ukrainë po ndodh ngjashmërisht, po synohet të arrihet ky balancim forcash duke rritur personelin ushtarak, armatimin dhe aftësinë luftarake të Kievit për ta barazuar me rusët përballë. Frika e shkatërrimit të ndërsjellë dhe shkuarjes së sigurt në një holokaust bërthamor global u shtua në vitet 60-të nga të dy palët, dhe i bëri ato më të përgjegjshme. Kërcënimet bërthamor injektoi atëherë dhe shpresojmë ta bëjë edhe sot, në politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik, një element të theksuar frike, frenimi dhe përgjegjshmërie. Konfrontimi i drejtpërdrejtë në atë periudhë u zëvendësua kryesisht me frikësim të palëve, nëpërmjet një garë masive armësh, produktet vdekjeprurëse të së cilës nuk u përdorën asnjëherë.

Analistë ushtarakë kur parashikojnë një sulm që mund të ndodhë ose jo, marrin në konsideratë ligjësitë dhe faktorët mbi ushtarakët që do ta mundësonin ose shmangnin këtë përballje, ndër të cilat më kryesore janë;

a. Raporti i forcave nuk është në favor të Rusisë, pasi 150 000 trupa në mësymje do ndaloheshin vetëm nga mbi 50 000 ushtarë ukrainas sipas doktrinës së luftës frontale konvencionale;

b. Morali i trupave gati për luftë, është faktor në favor të Ukrainës, pasi luftohet për atdheun e tyre dhe i gjithë populli ukrainas është i motivuar dhe i përfshirë në trajnime për përdorim të armatimit;

c. Aleancat dhe mbështetja ndërkombëtare janë faktorë në favor të Kievit, pasi Rusia ka mbetur e vetme me Kinën abstenuese "pro Rusisë dhe pro paqes", bashkë me aleatët e CSTO: Armenia, Bjellorusia, Kazakistan, Kirgistani dhe Tashkistani.

d. "Ushtria marshon mbi stomakun e vet" -na mëson Napolon Bonaparte, dhe e ka fjalën për logjistikën. Logjistika që mbështet luftën është një barrë e rëndë për ekonominë ruse,

shtuar kësaj edhe sanksionet e mundshme ndërkombëtare që mund t'i vihen në çdo moment.

e. Befasia, e cila ndoshta edhe qëllimisht, nuk është në favor të Moskës, por po i jep kohë Kievit dhe aleatëve të Ukrainës të përgatisin "varrin rus në Ukrainë".

f. Mbështetja e brendshme është në rënie, pasi opozita ruse është në protestë. Ky është një argument tjetër shtesë në disfavor të Moskës, pasi demonstratat kundër luftës sapo kanë filluar dhe gjasat janë të përshkallëzohen në vartësi të ecurisë së situatës.

Në përmbledhje të këtyre analizave dhe faktorëve, arrihet në përfundimin e pritshëm që nuk do ketë një luftë konvencionale frontale në Ukrainë, pasi rezultati të jetë fundi për regjimin dhe veprën e "Vladit të cmendur". Luftëra të kufizuara asimetrike dhe hibride nuk do të ndalen në këtë rajon dhe nuk do të ndërpriten asnjëherë nga Moska. Lufta me inteligjencë, sajimi i "false flag", sulmeve të brendshme kanë ekzistuar, po ndodhin dhe nuk do ndërpriten për një kohë të gjatë nga rusët, jo vetëm në Ukrainë por në të gjithë perëndimin.

Kërkesat që Moska i bën SHBA-së dhe NATO-s për: largim të NATO-s nga lindja; mos anëtarësim të Ukrainës në aleancë, megjithëse kjo është e drejtë e çdo shteti sovran, të vendosë vetë për fatet e tij; largimin e armatimit konvencional nga vendet kufitare me Rusinë, janë qartësisht të papranueshme dhe kjo dihet edhe nga vetë Putin.

Kremlini thjesht kërkon të "blejë kohë" dhe të vazhdojë të paraqitet për popullin rus si "mbrojtës së sovranitetit të tokave ruse", dhe të paraqesin "Ukrainën si grabitëse të trojeve ruse". Moska po teston dhe analizon çdo lëvizje të mundshme në mbështetjen ndërkombëtare si dhe atë të brendshme. Në vartësi të këtij "sondazhi", që Putin po bën, se çfarë fiton dhe humbet, besohet se do të ndërmerren edhe hapat e tjerë.

NATO jo vetëm nuk i pranoi këto kushte, por i parapriu ato, duke deklaruar se jo vetëm Ukraina por edhe Gjeorgjia dhe shtete të tjera neutrale europiane kanë të drejtë të zgjedhin për t'u anëtarësuar në NATO. Shtetet anëtare të NATO-s pa përjashtim mbështetin Kievin, dhe janë duke zbatuar një praktikë parandaluese dhe paqësore të "Deterrence by Presence".

Megjithëse Ukraina nuk është anëtare dhe nuk përfiton nga artikulli 5 i NATO-s, pothuaj të gjithë vendet anëtare të saj, veç e veç deri tani, kanë dënuar kërcënimin rus dhe po e mbështesin ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht popullin ukrainas.

Situata në dimrin e "ftohtë" e 2021-2022 në kufirin rus-ukrainas, i mbart tiparet e përjetuara në luftën e "ftohtë", me aktorë të vjetër dhe aleanca e reja, por zgjidhja përsëri qëndron si atëherë, tek "racionaliteti" apo "çmenduria" e liderëve.

Hapësirë: BE nis një sistem lidhjeje satelitor dhe rrit veprimet për menaxhimin e trafikut hapësiror për një Europë më dixhitale dhe më elastike

Sot, BE-ja po vepron sipas ambicieve të saj hapësirore duke paraqitur dy iniciativat: një propozim për një rregullore mbi një lidhje të sigurt, të bazuar në hapësirë dhe një komunikim të përbashkët mbi një qasje të BE-së për Menaxhimin e Trafikut Hapësiror (STM). Teknologjia hapësirore është thelbësore për të lehtësuar jetën tonë të përditshme, duke kontribuar në një të ardhme më dixhitale, të gjelbër dhe më elastike për planetin tonë. Si një fuqi e madhe hapësirore, Programi Hapësiror i BE-së, tashmë, ofron të dhëna dhe shërbime të vlefshme për një gamë të gjerë aplikimesh ditore nga transporti, bujqësia dhe reagimi ndaj krizës në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Megjithatë, për shkak të sfidave të reja dhe rritjes së konkurrencës ndërkombëtare, politika hapësirore e BE-së duhet të evoluojë dhe përshtatet vazhdimisht nëse duam të vazhdojmë të gëzojmë lirisht përfitimet që sjell hapësira. Iniciativat e sotme do të ndihmojnë në ruajtjen e efikasitetit dhe sigurisë së aseteve tona aktuale ndërkohë që zhvillojmë teknologjinë hapësirore europiane të avancuar në dobi të qytetarëve dhe ekonomisë sonë.

Lidhje e sigurt e bazuar në hapësirë

Në botën e sotme dixhitale, lidhja e bazuar në hapësirë është një aset strategjik për qëndrueshmërinë e BE-së. Ai mundëson fuqinë tonë ekonomike, udhëheqjen dixhitale dhe sovranitetin teknologjik, konkurrencën dhe përparimin shoqëror. Lidhja e sigurt është bërë një e mirë publike për qeveritë dhe qytetarët europianë. Kështu, Komisioni po parashtron një plan ambicioz për një sistem të sigurt komunikimi të bazuar në hapësirë të BE-së që do të: sigurojë disponueshmërinë afatgjatë të aksesit të pandërprerë në mbarë botën në shërbimet e komunikimit satelitor të sigurt dhe me kosto efektive; do të mbështesë mbrojtjen e infrastrukturës kritike, mbikëqyrjen, veprimet e jashtme, menaxhimin e krizave dhe aplikimet që janë kritike për ekonominë, sigurinë dhe mbrojtjen e Shteteve Anëtare; do të lejojë ofrimin e shërbimeve komerciale nga sektori privat që mund të mundësojë akses në lidhje të avancuara, të besueshme dhe të shpejta për qytetarët dhe bizneset në të gjithë Europën, duke përfshirë në zonat e vdekura të komunikimit që sigurojnë kohezionin në të gjithë Shtetet Anëtare. Ky është një nga objektivat e propozuar të "Dekadës Dixhitale 2030". Sistemi do të sigurojë gjithashtu lidhje me zonat gjeografike me interes strategjik, për shembull Afrikën dhe Arktikun, si pjesë e strategjisë "Global Gateway" të BE-së.

Si nevojat qeveritare të përdoruesve ashtu edhe zgjidhjet e komunikimit satelitor po ndryshojnë me shpejtësi. Sistemi i komunikimit të sigurt, i bazuar në hapësirë dhe BE-së, kërkon të përmbushë këto nevoja në rritje dhe në zhvillim, dhe do të përfshijë gjithashtu teknologjitë më të fundit të komunikimit kuantik për enkriptim të sigurt. Ai do të bazohet në zhvillimin e teknologjive inovative dhe përçarëse, dhe në shfrytëzimin e ekosistemit të hapësirës së re.

Kostoja totale është vlerësuar në 6 miliardë euro. Kontributi i Unionit në Program nga viti 2022 deri në vitin 2027 është 2.4 miliardë euro me çmime aktuale. Financimi do të vijë nga burime të ndryshme të sektorit publik (buxheti i BE-së, Shtetet Anëtare, kontributet e Agjencisë Europiane të Hapësirës (ESA) dhe investimet e sektorit privat.

Kjo nisim do të rrisë më tej konkurrencën e ekosistemit hapësiror të BE-së, pasi zhvillimi i një infrastrukture të re do të sigurojë një vlerë të shtuar bruto (GVA) prej 17-24 miliardë euro dhe vende pune shtesë në industrinë hapësirore të BE-së, me përhapje të mëtejshme pozitive. efektet në ekonomi nëpërmjet sektorëve të rrjedhës së poshtme duke përdorur shërbimet inovative të lidhjes. Qytetarët do të përfitonin gjithashtu nga avantazhet teknologjike, besueshmëria dhe performanca operacionale e shërbimeve të tilla të komunikimit satelitor që sigurojnë lidhje interneti me shpejtësi të lartë në të gjithë BE-në.



Menaxhimi i Trafikut Hapësiror

Me një rritje eksponenciale të numrit të satelitëve në orbitë për shkak të zhvillimeve të reja në lëshuesit e ripërdorshëm, satelitët e vegjël dhe iniciativat private në hapësirë, qëndrueshmëria dhe siguria e aseteve hapësirore të BE-së dhe Shteteve Anëtare janë në rrezik serioz. Është thelbësore të mbrohet qëndrueshmëria afatgjatë e aktivitetëve hapësirorë duke siguruar që hapësira të mbetet një mjedis i sigurt dhe i qëndrueshëm. Kjo e bën Menaxhimin e Trafikut Hapësiror një çështje prioritare të politikave publike, e cila kërkon që BE-ja të veprojë tani, kolektivisht dhe në një nivel shumëpalësh, nëse duam të sigurojmë një përdorim të sigurt dhe të qëndrueshëm të hapësirës për brezat që vijnë.

Në këtë sfond, Komisioni i Përbashkët vendos një qasje të BE-së për Menaxhimin e Trafikut Hapësiror. Qëllimi është të zhvillohen iniciativat konkrete, duke përfshirë operacionet dhe legjislacionin, për të promovuar përdorimin e sigurt, të sigurt dhe të qëndrueshëm të hapësirës duke ruajtur autonominë strategjike të BE-së dhe konkurrencën e industrisë.

Qasja e BE-së fokusohet në katër elementë:

-Vlerësimi i kërkesave dhe ndikimeve të STM civile dhe ushtarakë për BE-në;
-Forcimi i aftësive tona teknologjike për të identifikuar dhe gjurmuar anijen kozmike dhe mbeturinat hapësirore;

-Përcaktimi i kornizës së duhur normative dhe legjislative;

-Krijimi i partneriteteve ndërkombëtare për STM dhe angazhimi në një nivel shumëpalësh.


Për të zbatuar këtë iniciativë të re të bazuar në hapësirë, duke siguruar lidhje të sigurt në të gjithë Europën, Komisioni nisi në dhjetor 2020 një studim fillestar të sistemit për të eksploruar aspektet teknike dhe modelet e mundshme të ofrimit të shërbimeve.

Ndërkohë, Komisioni publikoi një thirrje shtesë për të përfshirë gjithashtu ekosistemin e Hapësirës së Re Europiane për të integruar idetë teknologjike më të avancuara dhe inovative nga SME-të dhe bizneset fillestare. Dy kontrata janë dhënë në dhjetor 2021 dhe puna teknike tani është duke vazhduar me rezultatet që priten deri në qershor 2022.

Menaxhimi i Trafikut Hapësiror

Që nga viti 2016, Unioni tashmë ka një aftësi të mbikëqyrjes dhe Gjurmimit të Hapësirës (SST), të zbatuar nga Konsorciumi SST i BE-së. Më shumë se 130 organizata europiane nga 23 shtete anëtare janë regjistruar deri më tani në shërbimet SST të BE-së (shmangia e përplasjeve, analiza e fragmentimit, analiza e rihyrjes). Sot, më shumë se 260 satelitë të BE-së, duke përfshirë flotën Galileo dhe Copernicus, përfitojnë nga shërbimi i shmangies së përplasjeve.

Në vitin 2021, partnerët e EU SST ndanë 100 milionë matje përmes platformës së tyre të ndarjes së të dhënave. Së fundmi, shërbimi i fragmentimit të BE-së SST konfirmoi zbulimin dhe monitorimin e mbetjeve hapësirore nga shkatërrimi i një sateliti në orbitë të ulët (COSMOS 1408) pas një testi anti-satelitor të kryer nga Rusia më 15 nëntor 2021.



“Sakrifica për shtetin tonë ka qenë jashtëzakonisht e madhe mbi 13 mijë civilë prej të cilëve 1 mijë e 133 e më shumë fëmijë, rreth 20 mijë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës, mbi 130 mijë shtëpi të shkatërruara, shumë monumente kulturore e mbi 1 mijë e 600 të zhdukur janë plagë akoma e hapur e Republikës sonë”, -deklaroj presidentja Osmani.



14-VJETORI I PAVARËSISË

Presidentja Osmani: Liria e Kosovës do të jetë e plotë kur do të vihet drejtësi për të gjitha viktimat e luftë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti uruan të gjithë qytetarët për 14-vjetorin e pavarësisë, ndërsa përkujtuan edhe të gjithë të rënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Në ceremoninë e ngritjes së flamurit shtetëror mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari.

Duke e quajtur pavarësinë e Kosovës si arritja më kulminante e popullit shqiptar, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani përkujtoi të gjithë ata që kontribuan në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Osmani u shpreh se liria e Kosovës do të jetë e plotë kur do të vihet drejtësi për të gjitha viktimat e luftës dhe kur të kthehet edhe qytetari i fundit i zhdukur.

Osmani kërkoi unitet për të tejkaluar sfidat, ndërsa theksoi se 17 Shkurti i vitit 2008 njëherë e përgjithmonë është përcaktuar fati i Kosovës si shteti i pavarur dhe sovran.

Sakrifica për shtetin tonë ka qenë jashtëzakonisht e madhe mbi 13 mijë civilë prej të cilëve 1 mijë e 133 e më shumë fëmijë, rreth 20 mijë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës, mbi 130 mijë shtëpi të shkatërruara, shumë monumente kulturore e mbi 1 mijë e 600 të zhdukur janë plagë akoma e hapur e Republikës sonë dhe liria jonë do të jetë e plotë atë ditë kur do të ketë drejtësi për të gjitha viktimat dhe atë ditë kur deri edhe qytetari ynë i fundit do të kthehet në Republikën tonë, te shteti i vet, te familjet e tyre. Në këtë ditë natyrisht festojmë edhe arritjet e Republikës së Kosovës, sepse shteti ynë është natyrisht punë e përfunduar dhe më 17 shkurt 2008 është përcaktuar njëherë e përgjithmonë fati ynë si shtet i pavarur dhe sovran dhe në këto sfida duhet të qëndrojmë të bashkuar sepse historia jonë ka dëshmuar çdo herë se vetëm atëherë kur jemi të unifikuar dhe të bashkuar rreth qëllimit për ta bërë



Kosovën shtet të suksesshëm, shtet që i del zot qytetarëve të vet, shtet me të cilin mburren që të gjithë të rinj dhe të vjetër atëherë vërtet mund të kemi sukses”, -deklaroj presidentja Osmani.

Kurse, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ndërsa uroi qytetarët për ditëlindjen e 14-të të pavarësisë së Kosovës, u shpreh se shteti i Kosovës do të qëndrojë lart dhe i paepur përgjithmonë.

“Edhe vetë fakti që këtë ditë po e fillojmë me ngritjen e flamurit të shtetit tonë është një simbolikë që tregon se shteti ynë do të qëndrojë lartë dhe i paepur përgjithmonë, të gjithë do e shënojmë këtë ditë të rëndësishme të shtetit tonë me aktivitet të shumta ashtu siç e meriton kjo ditë e rëndësishme. Prandaj, shfrytëzoj rastin që të gjithë qytetarëve të Kosovës t’iu uroj Ditën e Pavarësisë”, -tha ai.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti krahas urimit për qytetarët e Kosovës për 14-vjetorin

e pavarësisë ka përkujtuar edhe të gjithë ata që luftuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Ai u shpreh se ata të cilët punuan dhe luftuan kanë lënë gjurmë të pashlyera për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës.

“Teksa urojmë dhe festojmë gëzohemi dhe e urojmë njëri-tjetrin nuk kemi se si të mos kujtojmë dhe përkujtojmë ata të cilët punuan dhe luftuan për lirinë e popullit dhe pavarësinë e vendit. Andaj nga kryeqyteti i Republikës këtu në oborrin e përbashkët të Presidencës, Kuvendit dhe Qeverisë ku bëmë nderime dhe ngritëm flamurin shtetëror do të vazhdojmë për kryeqendrën e kryengritjes së popullit tonë në Prekaz, pra te kompleksi “Adem Jashari” dhe më pastaj tek varri i presidentit, Ibrahim Rugova dhe veprimtarit, Adem Demaçi. Të gjithë ata të cilët punuan dhe luftuan kanë lënë gjurmë të pashlyera për të sotmen dhe të ardhmen tonë andaj ne u jemi falënderues të gjithëve



mirënjohës përjetë”, -tha Kurti.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt të vitit 2008 në orën 15:39, në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në një mbledhje të jashtëzakonshme ku merrnin pjesë 109 deputet nga gjithsej 120, Kuvendi i

Kosovës shpalli njëzëri Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik.

Deklarata e pavarësisë së Kosovës dhe shpallja e pavarësisë ishte bërë nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, ndërsa president atë kohë ishte, Fatmir Sejdiu.



Ambasadori Reka theksoi se Shqipëria ishte një mbështetëse e fortë e Maqedonisë së Veriut për anëtarësimin në NATO dhe se vendi mbetet i përkushtuar për zhvillimin e bashkëpunimit në mbrojtje me Maqedoninë e Veriut, tashmë si aleate në Aleancë.



Takimi

Ministrja Sllavjanka Petrovska ka takuar ambasadorin e Shqipërisë në Maqedoninë e Veriut, z. Fatos Reka.

Ministrja Petrovska theksoi se Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë vende fqinje dhe mike dhe se bashkëpunimi bilateral në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë e reflekton pikërisht këtë. Aktivitetet e stërvitjeve të përbashkëta kontribuojnë në forcimin e ndërveprimit dhe ngritjen e nivelit të trajnimit dhe gatishmërisë së pjesëtarëve të të dy ushtrive.

“Pjesëmarrja e pjesëtarëve të ushtrisë shqiptare në stërvitjen e ardhshme “Swift Response 22” është një tjetër konfirmim i aleancës mes dy vendeve dhe dy ushtrive”, -tha ministrja. Ambasadori Reka theksoi se Shqipëria ishte një mbështetëse e fortë e Maqedonisë së Veriut për anëtarësimin në NATO dhe se vendi mbetet i përkushtuar për zhvillimin e bashkëpunimit në mbrojtje me Maqedoninë e Veriut, tashmë si aleate në Aleancë. Petrovska dhe Reka u pajtuan se siguria rajonale është prioritet për të dyja vendet dhe se bashkëpunimi dhe kontributi i përbashkët në iniciativat rajonale të sigurisë do të vazhdojë.

Ministrja Petrovska: Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë fqinjë dhe aleatë të ngushtë



Ministrja Petrovska në takimin ministror të NATO-s: Konfirmim i unitetit të vendeve anëtare, diskutime për sigurinë e zonës euroatlantike

Ministrja e Mbrojtjes, Sllavjanka Petrovska, mori pjesë në takimin e Aleancës, në nivel të Ministrave të Mbrojtjes në selinë e NATO-s në Bruksel. Ky është takimi i parë ministror në të cilin merr pjesë Petrovska, pas marrjes së postit të ministres së Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut.

“Ky takim po mbahet në një moment jashtëzakonisht të rëndësishëm si për sigurinë europiane ashtu edhe për atë të zonës euroatlantike. Ajo që pritet nga ne si ministra të mbrojtjes është të riafirmojmë pozicionin tonë për qëndrimin për një zgjidhje paqësore të çështjes së hapur midis Ukrainës dhe Rusisë”, -tha ministrja.

Petrovska theksoi se shansi i jepet para së gjithash dialogut dhe zgjidhjes diplomatike dhe se detyra kryesore e Aleancës është të mbrojë sigurinë dhe stabilitetin e shteteve anëtare.

“Deri në fund i japim një shans dialogut, zgjidhjes diplomatike.



Si Aleancë, ne kemi detyrimin të mbrojmë integritetin territorial dhe sigurinë e të gjitha shteteve anëtare të Aleancës. Ajo që pres dhe jam e bindur që do të dalë nga ky takim është që të konfirmohet uniteti i të gjitha vendeve anëtare dhe të merren vendime që do të jenë në atë drejtim”, -përfundoi ministrja.

Në takimet e NATO-s do të bisedohet gjithashtu për forcimin e aftësive mbrojtëse, investimin në mbrojtje, konceptin e ri strategjik të Aleancës dhe konceptin e NATO-s 2030. Ministrat e mbrojtjes të NATO-s do të diskutojnë edhe ndërtimin e kapaciteteve për të luftuar kërcënimet hibride, nevojën për të forcuar sigurinë kibernetike dhe rritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike.

Ministrja gjatë takimeve të Këshillit të Atlantikut të Veriut do të ketë disa takime dypalëshe me homologët e saj nga vendet aleate.

Consumers in financial services: how to enhance their financial education?

Joint ESAs high-level conference on financial education and literacy 2022

1 & 2 February 2022

EBA
EUROPEAN
BANKING
AUTHORITYEIOPA
EUROPEAN
INSURANCE
AND
PENSION
CORPORATE
INSURANCE
AND
PENSION
AUTHORITYesma
European Securities and
Markets Authority

KONFERENCA E PËRBASHKËT E NIVELIT TË LARTË E ESA-S MBI EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN FINANCIAR, 2022

Konsumatorët në shërbimet financiare: Si të përmirësohet edukimi i tyre financiar?

Autoriteti Europian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Autoriteti Europian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA) dhe Autoriteti Bankar Europian (EBA), organizuan bashkërisht këtë konferencë të nivelit të lartë për edukimin dhe arsimimin financiar. Nisma e tre Autoriteteve Mbikëqyrëse Europiane (ESA) për organizimin e konferencës kishte si qëllim mbledhjen e ekspertëve nga autoritetet publike, akademike, organizatat joqeveritare, shoqatat e konsumatorëve dhe industria, me synim grumbullimin e ideve, stimulimin e diskutimeve për edukimin financiar, ndërgjegjësimin, shkëmbimin e përvojave dhe identifikimin e praktikave të mira.

Diskutimet u përqendruan rreth katër temave, me prezantime hyrëse “informuese”, të ofruara nga ekspertë në fushat përkatëse që u diskutuan nga panellet pasuese:

1-Edukimi financiar dhe Unioni i Tregut të Kapitalit

Panelistët ranë dakord se edukimi financiar është një pikënisje e rëndësishme që mund t'i inkurajojë njerëzit të kursejnë dhe të investojnë afatgjatë, pasi njerëzit që janë të arsimuar financiarisht kanë më shumë gjasa të kuptojnë, të bëjnë pyetjet e duhura dhe të përfitojnë nga mundësitë e ofruara nga tregjet e kapitalit. Gjatë sesionit u diskutua rëndësia e promovimit të iniciativave të edukimit financiar që synojnë të rinjtë dhe të rriturit, nevoja e zhvillimit të programeve që do të ofrohen në shkolla për të rinjtë, si dhe rëndësia e promovimit të edukimit financiar në vendin e punës dhe në pikën e shitjes për të rriturit. Në këtë kontekst, u dhanë njohuri mbi kornizën e kompetencave financiare për të rriturit dhe të rinjtë, të zhvilluara së bashku nga Komisioni Europian dhe Rrjeti Ndërkombëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik për Edukimin Financiar (OECD-INFE). Për më tepër, panelistët ranë dakord se edukimi financiar në vetvete nuk është i mjaftueshëm dhe se nevojiten gjithashtu kërkesa të forta për mbrojtjen e investitorëve për të siguruar trajtim të drejtë dhe mbështetje të mirë për të gjithë klientët. Si përfundim, u diskutua roli i aktorëve publikë dhe privatë; anëtarët e panelit shkëmbyen mendime rreth prioriteteve dhe sfidave kryesore në promovimin e iniciativave efektive të edukimit financiar dhe dhanë shembuj konkretë nga përvojat e drejtpërdrejta në zhvillimin e programeve arsimore.

2-Edukimi financiar dhe dixhitalizimi me fokus të veçantë në sigurinë kibernetike dhe mashtrimet

Sesioni u hap me një përmbledhje të shkurtër të dosjes me tematika të përbashkëta të ESA-s mbi dixhitalizimin, me fokus të veçantë në sigurinë kibernetike dhe mashtrimet, e cila u publikua përpara ngjarjes në faqet e internetit përkatëse të tre ESA-ve. Dosja mbledh më shumë se 120 iniciativa të edukimit financiar rreth sektorit bankar, sigurimeve, pensioneve dhe investimeve të nisura nga Autoritetet Kompetente Kombëtare. Gjatë diskutimit në panel, u vu re se mashtrimet në internet po bëhen më të sofistikuar dhe se pagesat online janë veçanërisht të rrezikuara. Prandaj, edukimi i konsumatorëve për sigurinë kibernetike dhe mashtrimet përfaqëson diçka që kërkon një përpjekje të vazhdueshme. Në këtë drejtim, përpjekjet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve kompetente dhe institucioneve financiare mund të përbëjnë një mjet efektiv për t'i bërë

konsumatorët më të ndërgjegjshëm dhe më të kujdesshëm në një mjedis dixhital. U nënvizua gjithashtu roli i rëndësishëm që luan vërtetimi me dy faktorë në pagesat në internet për të reduktuar mashtrimin, megjithëse një e treta e audiencës tregoi se ata nuk ndiheshin të informuar siç duhet paraprakisht pse u prezantuan këto kërkesa sigurie.

3-Edukimi financiar dhe qëndrueshmëria financiare e grupeve të cenueshme

Panelistët ranë dakord se pandemia ka prekur veçanërisht ato grupe që ishin tashmë të cenueshme para pandemisë, në veçanti gratë (të moshuarit), familjet e reja dhe sipërmarrësit e vegjël. Disa panelistë theksuan se rregullorja duhet të rregullohet në mënyrë që teknologjitë e reja të mund të përdoren për t'u ofruar konsumatorëve informacion në një mënyrë intuitive, duke lejuar në të njëjtën kohë dhënie të informacionit në letër për popullatat e cenueshme të cilat nuk mund të kenë akses lehtësisht në teknologjitë dixhitale ose internetin.

Gjithashtu u nënvizua rëndësia e zbulimit të informacionit financiar që u mundëson konsumatorëve të krahasojnë produkte të ndryshme. Bazuar në një anketë të kryer nga audiencia, pati mbështetje të veçantë për ESA-të për të trajtuar çështjen e edukimit financiar dhe qëndrueshmërisë financiare të grupeve të cenueshme, duke zhvilluar praktikatat më të mira për iniciativat kombëtare të edukimit financiar që synojnë grupet e cenueshme. U arrit në përfundimin se edukimi financiar mund të jetë një mburojë efektive për grupet e cenueshme, për t'u mbrojtur nga goditjet financiare dhe se nëse përmirësojmë edukimin financiar, të gjithë do të përfitojnë, duke përfshirë rregullatorët, bankat, pensionet, siguruesit dhe, në veçanti, grupet e cenueshme.

4-Edukimi financiar dhe financat e qëndrueshme

Në lidhje me financat e qëndrueshme dhe taksonominë, panelistët theksuan se, megjithëse edukimi financiar është i rëndësishëm, ai nuk mund të konsiderohet një ilaç. Investitorët

me pakicë duhet të jenë të informuar në mënyrë adekuate dhe të aftë për të kuptuar një sasi të madhe informacioni të ofruar, por një barrë e tillë nuk mund të vendoset vetëm mbi konsumatorët dhe investitorët. Për të shmangur dëmin e konsumatorit, panelistët ranë dakord që këshilltarët financiarë duhet të trajtohen dhe certifikohen. Në këtë kontekst, u theksua roli i rëndësishëm i këshilltarëve të pavarur financiarë. Një panelist vuri në dukje se momenti më i përshtatshëm për iniciativat e edukimit financiar është momenti kur një person kërkon, krahason, kontraktos ose përdor një produkt ose shërbim financiar. Qëllimi i nismave të tilla duhet të jetë të ndihmojë konsumatorët të kuptojnë produktin, veçoritë e tij dhe rreziqet që lidhen me të. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kontekstin e financave të qëndrueshme, pasi aspektet e qëndrueshmërisë i bëjnë produktet dhe shërbimet më komplekse. Si rrjedhojë duhet futur në shkollat edukimi financiar me qëllim edukimin sa më të hershëm të fëmijëve. Për më tepër, panelistët theksuan se jo vetëm konsumatorët dhe investitorët me pakicë duhet të jenë të arsimuar financiarisht, por edhe mbikëqyrësit, rregullatorët dhe vetë institucionet financiare duhet të kenë parasysh mundësitë e ndryshme të trajnimit dhe mësimdhënies. “Kudri i kompetencës financiare për të rriturit në Bashkimin Europian”, i publikuar së fundmi nga Komisioni Europian dhe Rrjeti Ndërkombëtar i OECD-së për Edukimin Financiar, u sugjeruan si shembuj të dobishëm. Panelistët diskutuan gjithashtu rëndësinë e vlerësimit të përshtatshëm të produkteve dhe shërbimeve financiare. Në këtë drejtim, nevojitet një angazhim më i fortë i institucioneve financiare për t'i njohur më mirë klientët e tyre në mënyrë që t'u ofrojnë atyre këshilla më të përshtatshme për të blerë produktet dhe shërbimet financiare më të përshtatshme. Panelistët theksuan se pika e shitjes duhet të jetë një pikë dialogu dhe se, në kuadrin e financimit të qëndrueshëm, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe qeverisjes së mirë korporative të institucioneve financiare dhe qëllimeve dhe/ose detyrave të qëndrueshmërisë së tyre.



Përgatitja dhe stërvitja e luftëtarëve të UÇK-së



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Në ndihmë të djemve të Kosovës

Shpërthimi i luftës në ish-Jugosllavi edhe pse ishte i pritsëm, si kohë nuk ishte i paparashikuar nga politika zyrtare e Shqipërisë moniste. Por shpërbërja dhe lufta në ish-Jugosllavi ndodhën njëkohësisht me rënien e sistemit socialist në Shqipëri. Rënia e sistemit në Shqipëri u shoqërua me tronditje e dëme të mëdha, me djegie e shkatërrime barbare dhe eksode masive. Fuqia e shtetit shqiptar po shteronte, rinia që përbënte forcën e ushtrisë, po braktiste atdheun. Kështu në kohën kur ne duhej të ishim më të fuqishëm se kurrë për t'i dhënë Kosovës ndihmën konkrete maksimale, u gjendem më të dobët se kurrë.

Në kuadrin e përgatitjes dhe zhvillimit të Luftës së Kosovës, pas përmbyesjes së sistemit në ish-Jugosllavi, populli shqiptar dhe kosovar shfaqën dhe afirmuan mjaft përvoja dhe dukuri të reja, si dhe konfirmuan angazhim për ndihmesë, organizim dhe përgatitje të luftëtarëve të lirisë. Si fillim afirmuan më me forcë dëshirën për çlirim kombëtar nga pushtimi shekullor serbo-sllav.

Presidenti shqiptar i atëhershëm, Ramiz Alia, me sa duket kishte arritur në përfundim se Kosova duhej ndihmuar me çdo kusht, sepse kishte ardhur momenti më i volitshëm dhe i papërsëritshëm për ta. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë i dobësonte fuqinë e saj ushtarake sepse e shpërqendronte fuqinë e ushtrisë jugosllave për ruajtjen e tërësisë territoriale në të gjithë republikat e Federatës që tashmë po shpërbëhej. Kosova po ngrihej dhe po kërkonte të drejtat e veta, njëllorji si kombet e tjerë të Jugosllavisë. Në cilësinë e Kryetarit të Shtetit, në një fjalim që mbajti në OKB në shtator 1990, paralajmëroi Bashkësinë Ndërkombëtare për padrejtësitë që i ishin bërë kombit shqiptar, duke shtruar problemin e rishikimit të këtyre padrejtësive historike. Ai paralajmëroi se shqiptarët e Kosovës nuk kërkojnë asnjë të drejtë më shumë nga ç' kërkojnë serbët, sllovenët, kroatët apo maqedonastit. Shqiptarët e Kosovës nuk kanë pranuar e nuk do të pranojnë të kenë më pak të drejta se ata. Ndërsa në vitin 1991, në funksionin e Komandantit të Përgjithshëm, mori mbi vete përgjegjësinë dhe urdhëroi dikasterin e përgatitjes për mbrojtje, që të ndihmoheshin djemtë e Kosovës me gjithçka të mundshme për t'u stërvitur ushtarakisht e për t'u armatosur e pajisur me qëllim që të fillonin luftën çlirimtare në Kosovë në një kohë me republikat e tjera veriore të Jugosllavisë.

Luftëtarët themelues të UÇK-së

Dy grupet themeluese të luftëtarëve të UÇK-së, në Shqipëri erdhën në tremujorin e katërt të vitit 1991. Grupi i parë ishte grupi i Zahir Pajazitit, i cili u përgatit në Elbasan dhe përbëhej nga rreth 54 luftëtarë. Ndërsa grupi i dytë kryesohej nga Adem Jashari dhe përbëhej nga 34 luftëtarë. Ky grup u përgatit në Tiranë, përkatësisht në Surrel, në malin e Dajtit. Këto grupe u përgatitën për rreth një muaj secili, përkatësisht në tetor dhe dhjetor të vitit 1991.

Grupi i Adem Jasharit u përgatit dhe stërvit nga ushtarakët shqiptarë Hysen Ymeri, Agron Dhimarko, Ylli Mici dhe Kastriot Hoxha. Përgatitja e tyre u morr përsipër nga shteti shqiptar dhe u realizua nga grupe me oficerë aktivë dhe në rezervë, por me formim të lartë profesional,



si dhe të përgatitur për luftën guerile.

Të gjithë këta luftëtarë u përgatitën në mënyrë të organizuar luftëtarë u përgatitën në mënyrë të organizuar ushtarak dhe nga pikëpamja ushtarake dhe nga përvoja e ushtrisë shqiptare. Trajnimi i këtyre grupeve konsistonte në përgatitjen e zjarrit, në përgatitjen fizike, në elemente të luftës guerile dhe elemente të tjerë të luftimit në terren dhe në qendrat e banuara, etj. Oficerët e ngarkuar e mirëprirën detyrën. E konsideruan dhe e vlerësuan si një nder të madh, që u bëhej duke u besuar të stërvitin kontingjentet e para që do të nisnin luftën çlirimtare në Kosovën e push-tuar nga Serbia. Këta e kryen me nder misionin, nuk ndjen lodhje, duke zhvilluar stërvitje deri në 16 orë në ditë.

Çdo inspektor ushtarak shqiptar jepte lëndën e tij ushtarake të profilizuar. Serioziteti i tyre në përgatitje zjarri dhe në qitje ishte shumë i madh. Ushtarakët shqiptarë iu mësuan të gjitha armët e lehta të këmbësorisë, nga pistoletat, pushka, automatiku, mitralozi i lehtë dhe i rëndë si dhe granatahedhësin e mortajat 60 mm dhe 120 mm. Të gjithë grupet përditë bënin qitje me armët e zjarrit për të fituar refleksat e shprehitë praktike të përdorimit luftarak të tyre. Ata zhvillonin dhe qitje kolektive si nga pozicione zjarri taktike, në kombinim me të gjitha llojet e armëve dhe me granata. Instruktorët shqiptarë kishin si qëllim t'i çlironim nga emocionet e luftës, t'i mësonin me krismat e pushkëve në luftë, por dhe me disiplinën dhe me zjarrin masiv të armëve dhe të rrisnin besimin në armatimin e tyre luftarak, duke i marrë armës maksimumin e mundshëm të saj, ruajtjen e rendimentit luftarak, si dhe në terrene e situata të larmishme luftarake e sa më të përafërta me ato të luftës dhe nëpër fushëbeteja. Kështu Shqipëria po kthehej në një bazë të sigurt e të besueshme jo vetëm për përgatitjen e grupeve

të luftëtarëve të ardhshëm të lirisë, por dhe për takime individuale mes tyre.

Shtëpitë e shqiptarëve u bënë baza kryesore e UÇK-së

Nga vitit 1993, duke qenë ilegal, Adem Jashari vjen përsëri në Shqipëri, për të takuar vëllain e tij, Rifatin, i cili vinte nga Gjermania. Ndërkohë, mori pjesë dhe në ceremoninë e diplomimit të anëtarit të celulave të UÇK-së, Kadri Veselit, që studioje në Tiranë. Duke qenë se në Shqipëri vinin ilegalisht, e për masa sigurie e ruajtje të fshehtësisë, ata e kishin të ndaluar të lëviznin në vende publike dhe të pa kontrolluara. Adem Jashari dhe shokët e tij, gjatë kohës që përgatiteshin në Tiranë, zhvilloi dhe një aktivitet të gjerë në interes të objektivit për të cilin përgatiteshin. Ademi Jashari edhe kohë më parë, kishte kontakte me njerëz që vinin ilegalisht nga perëndimi për probleme të çështjes kosovare. Takimet bëheshin në Tiranë dhe në Durrës. Në Durrës, bazën e kishin në shtëpinë e Ramë Sylmetës, nga Kërçina e Gjakovës, dhe që ishte me banim në Zvicër. Kjo shtëpi u kthye në një bazë të rëndësishme të UÇK-së, si para, ashtu dhe gjatë luftës në Kosovë.

Kryesisht nga viti 1993 e në vazhdim, veprimtaria e aktivistëve (luftëtarëve) kosovarë erdhi në rritje në Shqipëri. Në këtë kohë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Manfred Vëmer, gjatë një vizite që bëri në Shqipëri në vitin 1993, më 19 mars, mbajti një fjalim para Kuvendit të Shqipërisë. Midis të tjerash, theksoi se: "Ministrat e Jashtëm të NATO-s kanë deklaruar se një shpërthim i dhunës në Kosovë, që mund të ndodhë nga përhapja e konfliktit, do të përbëjë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare... Përhapja e konfliktit në Kosovë... do të kishte pasojat më të tmerrshme... Aleanca jonë do të mbështesë

përpjekjet ndërkombëtare për të parandaluar që të mos ndodhë kjo dhe që të gjithë ne, në Aleancë, mbështetemi shumë te Shqipëria...".

Një urdhër i tillë nuk pritej nga Vëmer, që shqiptarët e konsideronin mik dhe e respektuan me të gjitha nderimet dhe komplimentet. Natyrisht, ai foli në emër të Europës, si udhëheqësi politik kryesor i NATO-s. Ky urdhër theksonte hapur që të mos përkrahej Shqipëria dhe asnjë formë qëndrese e armatosur e shqiptarëve të Kosovës kundër dhunës dhe gjenocidit serb, asnjë formë qëndrese e shqiptarëve të Kosovës për liri, sepse, sipas tij, kjo do të kishte "konsequenca të tmerrshme", dhe Qeveria Shqiptare, që kërkonte të anëtarësohej në Aleancë, nuk kishte si të mos zbatonte urdhrat e tij.

Megjithëse ndihma e shtetit shqiptar u bllokua, luftëtarët e Kosovës të cilët ishin të përkushtuar në çështjen e lirisë, duke shmangur kontaktet për ndihmë me institucionet e shtetit shqiptar, shfrytëzuan lidhje të ndryshme me ushtarakë dhe qytetarë atdhetar shqiptar. Ndaj me ndihmën e tyre gjetën mbështetje në Shqipëri te patriotët e vërtetë, krijuan baza të sigurta, qendra ilegale stërvitjeje dhe bënë furnizimin me armë e pajisje ndihmëse luftarake. Shpirti patriotik shqiptar u ngrit mbi politikën. Shqiptarët, edhe pse pa dëshirën e shtetit të vet e që u kushtëzua nga presioni i faktorit ndërkombëtar, sërish shtëpitë e tyre u bënë baza kryesore e UÇK-së dhe e Luftës së Kosovës. Madje me tendenca zgjerimi e masivizimi.

"Akademia" e stërvitjes në Farkë

Adem Shehu nga Farka e Tiranës, oficer kundërajror i Ushtrisë Shqiptare, diplomuar në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në vitin 1980 dhe shërbyer në reparte e njësi të Mbrojtjes Kundërajrore të Kryeqytetit, do të bëhej një nga komandantët më në zë të UÇK-së. Fillimisht u lidh me aktivistët kosovarë në Shqipëri dhe ktheu shtëpinë e vet në një qendër stërvitore dhe më pas duke shkuar vullnetarisht në Kosovë në kuadrin e luftës u bë deri komandant... Në vitin 1996 u lidh me ilegalët e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, me Sejdi Veselin, Nazmi Zhukën, sot dëshmorë i Kosovës, Fatmir Humollin e të tjerë.

Në vendlindjen e tij, në Farkë, në periferi të qytetit të Tiranës, organizoi stërvitjen luftarake të luftëtarëve të cilët vinin nga Kosova, nga trojet etnike dhe nga vendet perëndimore për t'u stërvitur. Grupet përbëheshin nga 25-30 veta dhe Adem Shehu i stërviste ata ilegalisht. Banesa e tij u shndërrua në një qendër stërvitore, në një "Akademi" ushtarake në Farkë. Stërvitja e çdo grupi vazhdonte rreth tri javë. Në stërvitje zhvillohej njohje armatimi, përgatitje zjarri dhe veprime të thjeshta taktike. Stërvitja përfundonte me qitje reale. Pas përfundimit të stërvitjes së grupit vinte grupi tjetër.

Pas marsit 1998, kur UÇK-ja kaloi në veprime luftarake në shkallë të gjerë, Adem Shehu mbante lidhje të vazhdueshme me luftëtarët që kishte përgatitur vetë. Atyre iu kërkonte t'i sillnin skicat e veprimeve luftarake dhe aktin e rënies së luftëtarëve në ndeshje me armikun. E shqetësonte së tepërmi rënia e luftëtarëve, të cilët ishte përpjekur t'i mësonte se si të vrisnin armikun e të mos vriteshin prej tij. Duke analizuar skemat e luftimit, ai arriti në përfundim të pasqyroj në stërvitjet me grupet pasardhëse mangësitë e organizimit të luftimit në terrenin konkret.



Redaksia e gazetës "Ushtria" uron: "Gëzuar Pavarësinë Shqipe"



Përkujtojmë heronjtë dhe dëshmorët e kombit dhe themi se gjaku i tyre është në themelin e shtetit të ri të Kosovës. Përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë me shekuj kishin për qëllim çlirimin e trojeve shqiptare dhe rikthimin e flamurit të Shqipërisë së Skënderbeut, Naimit Frashërit, Çerçiz Topullit, Ismail Qemalit, Isa Boletinit, Hasan Prishtinës, Adem Demaçit, Ukshin Hotit, Adem Jasharit, dhe të shumë dëshmorëve e heronjve të kombit që dhanë gjakun për liri. Respekt e nderim për arkitektin historik të Pavarësisë së Kosovës, Presidentin e parë, Dr. Ibrahim Rugova.

"Gëzuar Pavarësinë, Kosovë! Gëzuar këtë ditë të madhe për të gjithë shqiptarët! Sot, ne jemi të gjithë me mendje dhe me zemër në Kosovë. Përulemi para veprës së mijëra bijave e bijve të Kosovës dhe mbarë kombit që luftuan e sakrifkuan për këtë ditë të madhe.

Kosovë e së tashmes dhe e së ardhmes, të urojmë edhe shumë ditëlindje tjera, me shpresën që e ardhmja juaj e afërt të jetë pjesë e Aleancës Euro-Atlantike – NATO si dhe Bashkimit Europian.

E ardhmja e të gjithë shqiptarëve është e bekuar. Gëzuar Kosovë e shtrenjtë! Gëzuar shqiptarë kudo në botë!"